

GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT

P 186/13

14 prill 2014

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jete i formës së prere dhe munde të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT në Trupin Gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Mariola Pasnik, si kryetare e trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Franciska Fiser dhe gjyqtarja Teuta Krusha, si anëtarë të trupit gjykues, dhe Christine Sengl si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër:

1. të pandehurit S.N.,
2. të pandehurit M.K.,
3. të pandehurit T.K.,
4. të pandehurit S.K.,
5. të pandehurit A.B.,
6. të pandehurit N.K..

të akuzuar sipas Aktakuzës PP. nr. 190/09, të datës 3 dhjetor 2009, me të cilën të pandehurit S.N., M.K., T.K., S.K. dhe A.B., janë akuzuar për veprën penale të detyrimit, në shkelje të nenit 267 (2), lidhur me (1), të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "KPK"), i pandehuri N.K. akuzohet për veprën penale të kontraktimit të përfitimit joproporcional nga pasuria, në shkelje të nenit 270 të KPK-së,

pasi ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor të mbyllura për publikun më 27 nëntor 2013 dhe 6 dhjetor 2013, dhe seancat e shqyrtimit gjyqësor të hapura për publikun më 20, 26 nëntor 2013, 9 dhjetor 2013, 16, 20, 22, 27 janar 2014, 14, 19 shkurt 2014, 14 mars 2014, 11 prill 2014, në praninë e të pandehurit S.N., mbrojtësit të tij O.Z., të

pandehurit M.K., mbrojtëses së tij K.K., të pandehurit T.K, mbrojtësit të tij P.P., të pandehurit S.K, mbrojtëses së tij H.C., të pandehurit A.B, mbrojtësit të tij B.S., të pandehurit N.K, mbrojtësit të tij E.R., dhe Prokurorit Themelor të Prizrenit, Mehdi Sefa, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 11 prill 2014,

në pajtim me nenin 392 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme "KPPK"), më 14 prill 2014, në seancë të hapur dhe në prani të palëve, Gjykata jep dhe shpall këtë:

AKTGJYKIM

I.

Të pandehurit **S.N, M.K, T.K dhe S.K**, me shënime personale si ato të cekura më lart, në bazë të nenit 390 paragrafi 3 të KPPK-së,

LIROHEN NGA AKUZA NË AKTAKUZË

Duke filluar nga data 23.11.2007 dhe përtej kësaj date, të akuzuarit, duke vepruar si anëtarë të një grupi, me qëllimin për të përfituar në mënyrë të paligjshme për veten ose për një palë të tretë, përdorën forcë dhe bënë një kërcënim serioz kundër të dëmtuarit S.M., duke e detyruar të njëjtin të veprojë në mënyrë të tillë që dëmtoi pronën e tij. Ata siguruan një pasuri shumë të madhe pronësore, duke përfituar nga situata e vështirë financiare e të dëmtuarit. Kështu, më 23.11.2007, i pandehuri S.N, përmes një kërkesë të të dëmtuarit, i jep atij një shumë prej 23.000 €, me kamatë mujore 11%, ose 2.500 € në muaj, dhe nga kjo shumë i dëmtuari pagoi kamatë për 3-4 muaj. Më tej, Sk.i e njofton të dëmtuarin se, për shkak të detyrimeve që ai kishte ndaj të pandehurit M.K, i dëmtuari supozohej që nga tani e tutje kamatën t'ia paguante të pandehurit M.K. I dëmtuari vazhdon edhe dy muaj të tjerë t'i paguajë kamatë M.Kjt.

Meqë M.i po kryente dënimin (në burg), kamata iu pagua të pandehurit T.K, vëlla i M., për 4 muaj të tjerë. Kështu, më 24.07.2008, ai i dha shumën 13,000 € T.Kj, në emër të gjithëgjësë së borxhit; kamata në vlerën 10.000 € mbeti për t'u paguar. Gjithashtu, më 31.12.2008, i dëmtuari i dha atij 1,000 €. Duke mos qenë në gjendje të paguante pjesën tjetër të kamatës, ai bëri marrëveshje me T.Kj për ta shtyrë shlyerjen e borxhit deri në 01.05.2009, por në këtë datë i dëmtuari ishte i detyruar të paguante vetëm në formën e kamatës shumën 15.000 €. Ndërkohë, me kërkesë të të dëmtuarit, u përfshi edhe i

pandehuri S.K, për të shtyrë afatin e pagesës së borxhit dhe të kamatës. Por S.K i kërkoi të dëmtuarit 3.000 € si shpërblim për ndërmjetësimin e bërë mes tij dhe të akuzuarit T.Kj. Prandaj i dëmtuari ishte i detyruar t'i paguante S.Kt shumën 3.000 € më 01.09.2009. I dëmtuari nuk pati mundësi t'i shlyente këto detyrime ndaj S.Kt. S. i merr të dëmtuarit automjetin Golf 4, ngjyrë gri, me targa XXX-KS-XXX, prandaj borxhi bashkë me kamatën arrin shumën 52.000 €.

Me çka ata do të kishin kryer veprën penale të detyrimit, në shkelje të nenit 267 (2), lidhur me (1), të KPK-së.

Në bazë të nenit 390 paragrafi 3 të KPPK-së, kjo gjykatë gjen se nuk është provuar se të pandehurit S.N, M.K, T.K dhe S.K e kanë kryer veprën penale me të cilën janë akuzuar.

II.

I pandehuri **A.B**, me shënimet personale si më lart, në bazë të nenit 390 paragrafi 3 të KPPK-së,

LIROHET NGA AKUZA E AKTAKUZËS

Duke filluar nga data 01.12.2007 dhe përtej kësaj date, të akuzuarit, duke vepruar si anëtarë të një grupi, me qëllimin për të përfituar në mënyrë të paligjshme për veten ose për një palë të tretë, përdorën forcën dhe bënë një kërcënim serioz kundër të dëmtuarit Sh.M, nga Prizreni, duke e detyruar të njëjtin të vepronte në atë mënyrë që të dëmtonte pronën e tij. Ata siguruan një pasuri shumë të madhe pronësore duke përfituar nga situata e vështirë financiare e të dëmtuarit. Kështu, më 01.12.2007, përmes një kërkesë të të dëmtuarit, i pandehuri V.K i dha të dëmtuarit para me fajde në shumën 10.000 €, me kamatë mujore 10%. I dëmtuari ishte i detyruar t'i paguante shumën 1.000 € për dy muaj. Por më 01.02.2008, i pandehuri i jep të dëmtuarit për herë të dytë para me fajde në shumën 15.000 €, me kamatë mujore 10%. I dëmtuari arrin të paguajë kamatë mujore deri në maj 2008 në shumën 2.500 €, që do të thotë se shuma e përgjithshme e paguar si kamatë ishte 7,500 €. I pandehuri V.K, si ndërmjetësues midis A.B dhe të dëmtuarit, i dha të dëmtuarit shumën 25.000 € me fajde në maj 2008, me kamatë mujore 10%, ose 2,500 € kamatë në muaj. I dëmtuari arriti të paguajë vetëm kamatën deri në 31.09.2007, dhe nuk qe në gjendje të paguante gjithëgjënë e borxhit, i cili ishte në rritje. I pandehuri Af. e detyroi të dëmtuarin të shesë ngastrën e tokës në sipërfaqe 6

ari, e cila ndodhet afër hotel “Menes”, me një çmim prej 87.500 €, dhe nga kjo shumë 70.000 € do të llogariteshin në emër të fajdesë, ndërsa pjesën e mbetur prej 17,500 €, ai i dha nënës së tij.

Me çka A.B do të kishte kryer veprën penale të detyrimit, në shkelje të nenit 267 (2) lidhur me (1) të KPK-së.

Në bazë të nenit 390 paragrafi 3 të KPPK-së, kjo gjykatë gjen se nuk është provuar se i pandehuri A.B e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar.

III.

I pandehuri **N.K**, me shënimet personale si më lart, në bazë të nenit 390 paragrafi 1 të KPPK-së,

LIROHET NGA AKUZA E AKTAKUZËS

Se më datën 01.11.2007, i pandehuri N.K nga XXX, me qëllimin për të siguruar përfitim joproportional nga pasuria, për veten ose një person të tretë, duke përfituar nga gjendja e vështirë financiare e të dëmtuarit Sh.M nga Prizreni, i dha atij para në shumën 50.000 €, me kamatë mujore 11%, ose 5.500 € në muaj. I dëmtuari pagoi kamatë deri në 01.09.2008. Meqë i dëmtuari nuk ishte në gjendje t’ia vazhdonte shlyerjen e kamatës të pandehurit, Ne. shkon në dyqanin e tij të tekstilit dhe merr mallra në emër të borxhit, në vlerën 12-13 mijë euro; gjithashtu ai bën marrëveshje me të dëmtuarin që më 31.08.2009, i dëmtuari t’i kthejë gjithëgjënë e borxhit së bashku me kamatën.

Me çka, N.K do të kishte kryer veprën penale të kontraktimit të përfitimit joproportional nga pasuria, në shkelje të nenit 270 të KPK-së.

Në bazë të nenit 390 paragrafi 1 të KPPK-së, kjo gjykatë gjen se akti me të cilin akuzohet i pandehuri N.K, nuk përbën vepër penale.

SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

Në bazë të nenit 103 të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale nga neni 99, paragrafi 2, nën-paragrafët 1 deri në 5, të KPPK-së, shpenzimet e nevojshme të të gjithë të

pandehurve, përfshirë shpërblimin dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësve, paguhen nga mjetet buxhetore.

ARSYETIM

I. Ecuria procedurale

Më 2 tetor 2009, prokurori publik i qarkut lëshoi aktvendim për fillimin e hetimeve kundër S.Nt., M.Kt., T.Kt., S.Kt., V.Kt., A.B. dhe N.Kt.

Më 3 dhjetor 2009, prokurori publik paraqiti Aktakuzën (PP nr. 190/09, datë 3.12.2009) në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

Më 6 janar 2010, gjyqtari për konfirmim i Gjykatës së Qarkut në Prizren e konfirmoi aktakuzën kundër të gjithë të pandehurve.

Më 15 prill 2011, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ua caktoi lëndën gjyqtarëve të EULEX-it të Gjykatës së Qarkut në Prizren.

Më 10 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren shpalli Aktgjykimin P. nr. 11/10. Trupi gjykues i gjeti të pandehurit S.N, M.K, T.K, S.K, V.K dhe A.B jo fajtorë për veprat penale të detyrimit, ndërsa i pandehuri N.K u shpall jo fajtor për veprën penale të kontraktimit të përfitimit joproporcional nga pasuria.

Më 4 dhjetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar lidhur me ankesën e prokurorit publik kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, P. nr. 11/2010, të datës 10 nëntor 2011, shpalli aktvendim me të cilin e miratoi ankesën e prokurorit publik. Me këtë aktvendim, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut u anulua dhe lënda u kthye për rigjykim.

Më 20 nëntor 2013, filloi shqyrtimi gjyqësor, i cili vazhdoi më 26, 27 nëntor 2013, 6 dhe 9 dhjetor 2013, 16, 20, 22, 27 janar 2014, 14, 19 shkurt 2014, 14 mars 2014, 11 prill 2014. Palët nuk e kundërshtuan përbërjen e trupit gjykues.

Më 20 nëntor 2013, gjykata shqiptoi një urdhër-arresti kundër V.Kt për shkak të mosparaqitjes së tij në seancat gjyqësore.

Më 20 nëntor 2013, trupi gjykues i Gjykatës Themelore të Prizrenit, pas dëgjimit të palëve dhe mbrojtësve, në fillim të shqyrtimit gjyqësor më 20 nëntor 2013, në pajtim me nenin 34 të KPPK-së, shqiptoi një aktvendim me të cilin e ndau procedurën penale kundër të pandehurit V.K.

I. Kompetenca e Gjykatës

Sipas nenit 23 pika 1 i) të KPPK-së, gjykatat e qarkut shqyrtojnë lëndët penale që përfshijnë akuza për të cilat ligji lejon shqiptimin e dënimit penal për të paktën pesë vjet burgim. Të pandehurit S.N, M.K, T.K, S.K dhe A.B u akuzuan për veprën penale të detyrimit, në shkelje të nenit 267 (2), lidhur me (1), të KPK-së, që parasheh burgim prej një deri në dhjetë vjet, ndërsa i pandehuri N.K u akuzua për veprën penale të kontraktimit të përfitimit joproporcional nga prona, në shkelje të nenit 270 të KPK-së.

Prandaj Gjykata e Qarkut është organi kompetent për ta shqyrtuar këtë procedurë penale.

Më 15 prill 2011, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, me vendimin e saj në pajtim me nenin 3.6 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it ("Ligji për Kompetencat"), ua caktoi lëndën gjyqtarëve të EULEX-it të Gjykatës së Qarkut në Prizren.

II. Zbatimi i ligjit në rigjykim

Kodi i ri i Procedurës Penale (KPP) hyri në fuqi në 01.01.2013. Neni 544 i KPP-së parashikon se: "Nëse pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi paraqitet ankesë ose me mjet të jashtëzakonshëm juridik anulohet aktgjykimi, shqyrtimi gjyqësor zbatohet përshtatshëm sipas dispozitave të kodit të mëparshëm."

Për rrjedhojë, trupi gjykues i Gjykatës Themelore të Prizrenit zbatoi në këtë procedurë penale KPPK-në e vjetër.

I. Provat e administruara

1. Dëshmitarët

1. Sh. L. M. (i dëmtuar)
2. B. A. M.,
3. F. B. B.,
4. A. H. B.,
5. Sh. N. S.,
6. S. M. J.,
7. V. K. M.,

2. Provat me shkrim

Gjykata pranoi si provë deklaratat e mëposhtme, që u vlerësuan si të lexuara gjatë shqyrtimit gjyqësor:

1. Dëshmitë e dhëna nga Sh. L. M më 04 gusht 2009, 14 tetor 2009, 3 nëntor 2009 dhe në shqyrtimin e parë më 13 dhe 14 shtator 2011.
2. Dëshmitë e dhëna nga B. A. M më 21 tetor 2009 dhe në shqyrtimin e parë më 14 shtator 2011.
3. Dëshmitë e dhëna nga F. B. B më 2 nëntor 2009, dhe në shqyrtimin e parë më 14 shtator 2011.
4. Dëshmitë e dhëna nga A. H. B më 24 gusht 2009, 22 tetor 2009 dhe në shqyrtimin e parë më 14 shtator 2011.
5. Dëshmitë e dhëna nga Sh. N. S më 2 nëntor 2009 dhe në shqyrtimin e parë më 14 shtator 2011.
6. Dëshmitë e dhëna nga S. M. J më 3 nëntor 2009 dhe në shqyrtimin e parë më 14 shtator 2011.
7. Dëshmitë e dhëna nga V. K. M më 2 nëntor 2009.
8. Dëshmitë e dhëna nga Ar.B më 21 tetor 2009 dhe në shqyrtimin e parë më 14 shtator 2011.

3. Lista e dokumenteve të lexuara apo të vlerësuara si të lexuara gjatë shqyrtimit gjyqësor

E1. Aktgjykimi P. 133/2008.

E2. Aktakuza e PPK, e datës 27 korrik 2009, kundër Sh.Mt dhe Al.Bt dhe në atë lëndë Sh.M ishte akuzuar më 26 qershor 2009 në Prizren.

E3. Përgjigja nga Zyra e Prokurorit Disiplinor, me numër protokoli ZPD/09/KB/0879, datë 9 shtator 2009, për Sh.Mn. Ankesa ishte hedhur poshtë.

E4. Deklarata e Ar.B, i cili deklaroi me rastin e nënshkrimit të kontratës për shitjen e lokaleve afariste të ndodhura në Lamellën A5, njësia biznesore 9, Ortakoll 3, sipërfaqe 30 metra katrorë, se Ar.B i shiti personit me emrin Sh.M nga Prizreni njësinë e lartpërmendur me çmimin 2.500 euro. Më 25 tetor 2008, ai ka marrë këtë shumë të dakorduar në mënyrë të ndërsjellë.

E5. Deklarata e Sh.Mt lidhur me përmbajtjen, që është e krahasueshme me deklaratën tjetër dhe ka të njëjtën përmbajtje, me përjashtim të faktit se ishte Sh.M ai që ishte pala tjetër që e nënshkroi këtë dokument.

E6. Një deklaratë tjetër e Sh.Mt, ku ai deklaroi se i shiti Sh.St pronën e paluajtshme me sipërfaqe 4 ari, e ndodhur në parcelën kadastrale nr. 5147 në Kamenicë. Ai e shiti pronën e lartpërmendur me çmimin 90.000 euro.

E7. Kontrata e shitjes së pasurisë së paT.dshme midis Sh.St dhe Sh.Mt lidhur me ngastrën kadastrale nr. 5328/4, e ndodhur në Kamenicë, me një sipërfaqe prej 200 metrash katrorë (E7); çmimi i blerjes ishte 90,000 euro.

E8. Një tjetër deklaratë e bërë nga Sh.S më 4 tetor 2007, ku Sh.S deklaroi se i shiti Sh.Mt shtëpinë e ndodhur në Kamenicë në Prizren. Kjo ishte ngastra kadastrale nr. 5328 dhe çmimi i shitjes ishte 90.000 euro.

E9. Një dokument tjetër si provë është një dokument i Ministrisë së Shërbimeve Publike, Agjencia Kadastrale e Kosovës, i datës 11 dhjetor 2008, me aktvendimin e mëposhtëm: Kërkesa e A.B nga Suhareka miratohet. A.B kërkoi bartjen e pronësisë nga pronari i mëparshëm Sh.S nga Prizreni tek pronari i ri A.B të ngastrës kadastrale nr. 5251/4 me një sipërfaqe prej 0.06,02 ha, në Komunën e Prizrenit.

E10. Kopja e marrëveshjes me shkrim, e lidhur më 1 nëntor 2007 mes S.Nt dhe Sh.Mt.

E11, E12, E13 Faturat e datave 22 gusht 2008, 11 shtator 2008 dhe 5 dhjetor 2008 (E11, 12, 13).

- C1. Memorandumi zyrtar i Drejtorisë Rajonale të Prizrenit.
- C2. Informacioni mbi lëndët e ndryshme të paraqitura kundër të pandehurve.
- C3. INDP1818/09 Prokuroria Publike Komunale e Prizrenit - kundër Sh.Mt.
- C4. Numri i kopjes PP336/09, Prokuroria Publike Komunale e Prizrenit - Aktakuza kundër N.Kt.
- C5. PP1731/08, propozim-akuzë kundër S.Nt për kërcënim.
- C6. Propozim-akuza e datës 7 maj 2009, kundër S.Nt për heqjen e kabllorit të lidhur me njësisin elektrik.
- C7. PP2716/2010, Aktakuza kundër, ndër të tjerë, T.Kjt, lëndime të rënda trupore.
- C8. PP1942/05 kundër N.Kt, detyrim.
- C9. PP115/05 kundër T.Kjt, edhe Aktakuzë, lëndime të rënda trupore.
- C10. Aktgjykimi 133/2008, Gjykata e Qarkut në Prizren, ndër të tjerë, kundër M.Kjt dhe T.Kjt, vrasje.
- C11. Informacion nga Prokuroria Komunale e Prizrenit, e cila përmend lëndët e paraqitura kundër të pandehurve në raste të ndryshme dhe kjo e informon Gjykatën se çfarë ka ndodhur në ato lëndë. Disa lëndë janë në zhvillim.
- C12. Propozim-akuza 2540/2003 kundër T.Kjt, bashkëpjesëmarrje në lëndim të lehtë trupor.
- C13. Informacion në lidhje me Sh.Mn nga Prokuroria Komunale në Prizren në lidhje me lëndët e raportuara prej tij në Prokurori.
- C14. Aktakuza 1324/2003 ndaj T.Kjt, për falsifikim të dokumenteve.
- C15. Aktakuza 2543/2003 kundër T.Kjt, prodhim i armëve për kryerjen e veprave penale.

C16. Propozim-akuza PP1864/2004 kundër Sh.Mt, lidhur me energjinë elektrike dhe vjedhjen e numrave të energjisë.

Gjatë seancës së datës 26 nëntor 2013, gjykata pranoi si provë këto dokumente:

D1. Fletë-dorëzimi për Sh.Mn, Prot. nr. 164, datë 08.06.2013, referenca nr. 5572.

D2. Fletë-dorëzimi për Sh.Mn, Prot. nr. 182, datë 25.08.2013, referenca nr. 5957.

D3. Tomografi e kompjuterizuar e kraharorit të Sh.Mt, datë 5 gusht 2013, e nënshkruar nga radiologu Dr. Sy.K.

D4. Letër e Sh.Mt, datë 11.07.2013, e marrë më 11.11.2013, nr. arkivor 2013-COS-1569.

D5. Përgjigje e letrës së datës 21.11.2013, Ref. 2013-COS-1569, e nënshkruar nga Zyra e Shefit të Shtabit të EULEX-it në Kosovë, e dorëzuar nga Sh.M gjatë seancës më 27 nëntor 2013.

D6. Letër e Sh.Mt, datë 23.12.2013, e marrë më 27.12.2013, nr. 2013-COS-1569.

D7. Raport informues i diagnostikës, datë 26.11.2013, i nënshkruar nga Dr. B. M, mjek specialist pulmonolog.

D8. Njoftim i Drejtorisë Rajonale të Policisë, Stacioni Policor në Prizren, referenca 04/1-04P-0/1222/2013, datë 12.05.2013, lidhur me zbatimin e urdhrit të shqiptuar kundër V.Kt.

D9. Dokument i marrë nga FINCA, datë 11.12.2013.

D10. Dokument i marrë nga Banka Pro Credit, datë 19.12.2013.

D11. Dokument i marrë nga Banka Raiffeisen, datë 21.04.2014.

4. Deklaratat e të pandehurve dhënë trupit gjykues

1. S.N,
2. M.K,
3. T.K,

4. S.K,
5. A.B
6. N.K.

5. **Gjykata pranoi si provë deklaratat e mëposhtme, që u vlerësuan si të lexuara gjatë shqyrtimit gjyqësor:**

1. Deklaratat e S.Nt më 25 gusht 2009, 15 tetor 2009 dhe 15 shtator 2011,
2. Deklaratat e M.Kjt më 2 nëntor 2009 dhe 15 shtator 2011,
3. Deklaratat e T.Kjt më 27 gusht 2009, 19 tetor 2009 dhe 15 shtator 2011,
4. Deklaratat e S.Kt më 25 gusht 2009, 19 tetor 2009 dhe 15 shtator 2011,
5. Deklaratat e A.B më 30 gusht 2009, 20 tetor 2009 dhe 4 tetor 2011,
6. Deklaratat e N.Kt më 26 gusht 2009, 21 tetor 2009 dhe 15 shtator 2011.

II. Analiza individuale e provave dhe gjetjet ligjore

Akuza I e Aktakuzës

I dëmtuari Sh.M dëshmoi para policisë më 04.08.2013, përpara Prokurorit Publik të Prizrenit më 14.10.2009 dhe 03.11.2009, në shqyrtimin e parë gjyqësor më 13 shtator 2011, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor më 26 dhe 27 nëntor 2013.

Më 26 nëntor 2013, gjatë shqyrtimit gjyqësor, i dëmtuari Sh.M dëshmoi se ai kishte në pronësi një dyqan privat dhe punonte kryesisht me mallra të tekstit. Në vitin 2007 Sh.i kishte një dyqan privat, por në vitin 2009 ai kishte tre dyqane private. Atij nuk i kujtohet nëse ishte nëntor apo dhjetor i vitit 2007, kur ai i kërkoi para S.Nt. Kur dëshmoi më 14 tetor 2009, Sh.M deklaroi se ai i huazoi para S.Nt më 23 dhjetor 2007.

Sh.M mori para hua në shumën 23.000 euro nga S.N, me kamatë mujore 11%. Ishte Sh.i ai i cili i kërkoi të hollat. Ai i kërkoi këto të holla në mënyrë miqësore, për të hapur një dyqan. Sk.i i tha se nuk kishte të holla, por ai mund t'ia gjente. Ata bënë një marrëveshje me shkrim.

Në pyetjen e Kryetares së trupit gjykues: A mund të na tregoni për bisedën me S.Nn?

Sh.M: Bisedat mes meje dhe S.Nt ishin si vijon: "Sk., kam nevojë për 23,000 €. A do m'i jepje". Ai tha "Unë nuk kam të holla për të të dhënë, por do t'i gjej paratë, që duhen paguar me kamatë". Kur rashë dakord me kushtet e kamatës 11%, ai m'i solli paratë në

të njëjtën ditë. Unë i mora paratë dhe fillova t'i paguaj kamatë S.Nt, pasi ai ishte personi që m'i kishte sjellë paratë.

Sh.M i pagoi S.Nt 2500 euro kamatë për tre muaj. Kur dëshmoi më 27 nëntor 2013, Sh.M deklaroi se në muajin e katërt ai nuk kishte para t'i paguante kamatën Sk.t. Sk.i shkoi tek Sh.i me njërin prej vëllezërve K. dhe i tha Sh.it se ai i kishte borxh njërit prej vëllezërve K. dhe i kërkoi, nëse ishte e mundur, që borxhin që ai ua kishte atyre, ta merrte përsipër Sh.i". Sh.i e pranoi këtë. Sh.i nuk qe në gjendje t'i tregonte gjykatës se cili nga vëllezërit K. shkoi tek ai së bashku me S.Nn.

Sh.M: Binte shi, borë dhe kishte mjegull, ne hipëm në automjet, nuk e mbaj mend saktësisht tani, sepse këta dy vëllezër K. ngjasonin shumë me njëri-tjetrin, njëri ishte M.i, tjetri ishte N. Për shkak të stresit dhe gjendjes së motit, pasi ishte mjegull, mendova se ishte M.i. Kjo është e gjitha.

Prokurori: A dukej se ishte ai, apo ishte M.i?

Sh.M: Nuk jam i sigurt; mua m'u duk se ishte ai.

Kur Sh.i kishte marrë paratë nga Sk.i, ata kishin lidhur marrëveshje që Sh.i t'i mbante paratë për 3-4 muaj. Kur erdhi afati që Sh.i të kthente paratë, ai nuk kishte para për t'i kthyer.

Në dëshminë e dhënë më 4 gusht 2008, Sh.M dëshmoi se ai i pagoi M.Kjt dy këste të tjera mujore, por më 24 mars 2008, borxhi u bart nga M.i tek T. K.j (vëllai i M.it), sepse M.i u arrestua për vrasje dhe e kishin burgosur. Sh.i i pagoi T. K.jt katër këste mujore të tjera deri më 24 mars 2008 dhe në atë datë Sh.i i pagoi T. K.jt 13.000 euro dhe pjesa e borxhit e mbetur për t'u paguar ishte 10.000 euro, dhe Sh.i i pagoi atij 1.000 euro kamatë në muaj deri më 31 dhjetor 2008.

Në dëshminë e dhënë më 14 tetor 2009, Sh.i deklaroi se kontaktoi M. K.jn dhe ky pranoi. Sh.i vazhdoi t'i paguante M.it kamatën dhe gjithëgjënë e borxhit. Ai i pagoi M. K.jt 2.300 euro në muaj për katër muajt e ardhshëm.

Kur u pyet nga prokurori më 27 nëntor 2013 se cila deklaratë ishte e saktë, Sh.i u përgjigj se dëshmia e sotme është e saktë.

Kryetarja e trupit gjykues: Pse e keni ndryshuar dëshminë tuaj në lidhje me këtë rrethanë, cila është arsyeja që dëshmuat ndryshe në vitin 2009?

Sh.M: Ishte për shkak të motit të keq, isha nën stres dhe kisha probleme familjare, të dy vëllezërit dukeshin njësoj dhe nuk mund t'i dalloja.

Prokurori: A e ka kontaktuar ai M. K.jn pasi vazhdoi t'i paguante kamatën?

Sh.M: Përveç asaj nate, nuk e kam parë atë.

Prokurori: Kujt ia paguat borxhin, kush erdhi ta kërkonte atë?

Sh.M: Siç thashë, vazhdova të paguaj kamatën që i paguhej S.Nt në emër të vëllezërve K..

Prokurori: A ia paguat kamatën S.Nt, sepse ju përmendët se paguat vetëm tre muajt e parë?

Sh.M: Unë u përgjigja, pas asaj nate vazhdova të paguaj kamatë, që iu pagua Sk.t në emër të vëllezërve.

Në deklaratën e dhënë në shqyrtimin e parë më 13 shtator 2011, Sh.i deklaroi se, për sa u përket vëllezërve K., ai nuk kishte "bërë marrëveshje për huazim të parave me kamatë". Ai mohoi të kishte pasur ndonjë kontakt me ta.

Sh.M: Vëllezërit K. nuk kishin asnjë rol, paratë që mora borxh në shumën 23.000 euro, u dhanë nga S.N. Sa për shumën, S.N më kërkoi t'ua paguaj vëllezërve K.. Të gjitha paratë që pagova si kamatë, u paguan në emër të S.Nt dhe jo në emër të vëllezërve K., dua ta theksoj këtë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, Sh.M vazhdoi të dëshmojë se gjatë muajve të ardhshëm, borxhi iu pagua Sk.t në emër të vëllezërve K..

Kryetarja e trupit gjykues: Ju dhatë dëshmi të ndryshme, nuk është e njëjtë të thuash, "Pagova vëllezërit në emër të S.Nt" dhe tani thua: "Pagova S.Nn në emër të vëllezërve K.."

Sh.M: Ia pagova kamatën Sk.t, pasi ai më tha se paratë ishin të vëllezërve, që unë i kisha marrë dikur në mars.

Kryetarja e trupit gjykues: Mbarova leximin e dëshmive tuaja të mëparshme, ato janë krejtësisht të ndryshme. A e kuptoni?

Sh.M: Po.

Kryetarja e trupit gjykues: Pse dëshmuat ndryshe sot?

Sh.M: Sepse kjo është e vërteta.

Kryetarja e trupit gjykues: Pse nuk e thatë të vërtetën më 04 gusht 2008, 14 tetor 2009 dhe 13 shtator 2011?

Sh.M: Kam thënë të vërtetën atje dhe atëherë, kjo është ajo që po them sot.

....

Kryetarja e trupit gjykues: Pse e ndryshuat mendjen nga viti 2011, sepse në vitin 2011, para trupit gjykues dëshmuat se i paguat kamatë M.it dhe kur ai u arrestua, detyrimi juaj u bart tek T.K dhe ju nuk përmendët se nga viti 2008 ju i paguat kamatë S.Nt në emër të M. K.jt dhe T.Kjt. A mund ta shpjegoni?

Sh.M: Kam qenë nën stres në vitin 2009 dhe 2011.

Kryetarja e trupit gjykues: Dhe 2008?

Kryetarja e trupit gjykues: Kam qenë edhe më keq atë kohë, mua më duket se fjalët që po them tani janë të njëjta.

Kryetarja e trupit gjykues: Kjo është një dëshmi krejt e ndryshme.

Sh.M: Mua m'u duk sikur paratë iu dhanë S.Nt në emër të vëllezërve, mua më dukej njëjtë; edhe sot më duket njëjtë.

Tre muajt e parë Sh.i i pagoi S.Nt kamatë 11%, d.m.th. 2.500 euro çdo muaj; dhe për 5-6 muajt e mbetur kamata ishte 10%, d.m.th. 2.300 euro në muaj; më saktësisht, nga dhjetori deri në mars pagoi 11%, ndërsa nga marsi deri në gusht/shtator 2009 pagoi kamatë 10%.

Sh.i mori 13.000 euro kredi nga F., dhe ia dha ato Sk.t, dhe në atë kohë ai ende i detyrohej Sk.t 10.000 euro, të cilit Sh.i rifilloi t'ia paguajë me kamatë 10% çdo muaj, deri në Vitin e Ri. Pas Vitit të Ri, Sh.i i tha Sk.it se nuk kishte më biznes në dyqanet e tij, dhe i kërkoi, nëse ishte e mundur, që ai të mos paguante më kamatë deri në maj 2009. Sk.i i tha Sh.it se, në qoftë se ai dëshiron që ai të presë deri në maj për kthimin e parave, "10.000 eurot do të bëhen 15.000 euro". Atëherë, duke qenë në një situatë të vështirë, Sh.i u pajtua.

Kryetarja e trupit gjykues: Dje ju na thatë se morët 70.000 € kredi nga Banka F.. Sot na thatë se i paguat 13.000 euro S.Nt. Çfarë ndodhi me pjesën tjetër të parave të marra nga F.?

Sh.M: Për të marrë 70,000 € kredi, kisha pasur një kredi të mëparshme me ta, të cilën e shleva dhe kredia e mëparshme që ishte 50.000 €. Mua më dhanë 70,000 €, por unë mora vetëm 20.000 €. A e kuptoni?

Kryetarja e trupit gjykues: Po. Dje, i dëmtuari ynë tha se mori tre kredi, një në vitin 2004, nga Pro- Credit, në shumën 30.000 €, të dytën nga Raiffeisen Bank në shumën 65.000 euro dhe 70.000 € nga FINCA. Një ditë më pas, ju na thoni rreth 20.000 € nga FINCA dhe një kredi të mëparshme në shumën 50.000 € të marra po nga FINCA.

Sh.M: E kisha një kredi të mëparshme me FINCA-n. Që të merrja kredi të re nga FINCA, duhej të pastroja të mëparshmen.

Kryetarja e trupit gjykues: Unë kam një dokument nga FINCA dhe duket se juve ju dha vetëm një kredi në shumën 70.000 €.

Sh.M: Unë mora dhjetë kredi nga FINCA; kredia në shumën 70,000 € është kredia e fundit.

Kryetarja e trupit gjykues: A ia shlyet FINCA-s?

Sh.M: Jo.

....

Sh.M: Le të sigurohemi që e kemi sqaruar këtë, vetëm sepse unë jam në gjendje ta kuptoj atë që po them, kurse Trupi Gjykues nuk po e kupton, prandaj vij në kundërshtim me fjalët e mia. Kredia e parafundit ishte në shumën 60.000 € dhe, duke përfshirë edhe kamatën, unë duhej të paguaja 80.000 €. Këstet që përbëheshin në shumën 1.750 € u paguan, u pastruan 30.000 € nga totali; borxhi mbetur bankës ishte 50.000 €. Unë bëra kërkesë për një kredi tjetër dhe banka më tha të pastroja 30.000 eurot e para, në mënyrë që të merrja 70.000 euro. Ata i mbajtën 50.000 eurot dhe më dhanë 20.000 euro. Megjithatë u detyrohesh 70.000 €. A e kuptoni?

Kryetarja e trupit gjykues: Po. Për të qenë 100% e sigurt, do të pyes FINCA-n për të dhëna rreth kredive tuaja të marra nga FINCA, si dhe bankave të tjera, Pro Credit dhe Raiffeisen. (Shih eksponatet D9, D10 dhe D11).

Më 14 tetor 2009, Sh.i deklaroi se i kërkoi T.ës ta shtynte afatin e gjithëgjësë. T.a u pajtua dhe e shtyu atë me 5 muaj, deri më 1 maj 2009, Sh.i ishte i detyruar t'i kthente T.Kjt shumën e përgjithshme prej 15.000 eurosh.

Në dëshminë e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, Sh.M sqaroi se ishte S.N ai i cili e shtyu pagesën në emër të vëllezërve K.. Në maj 2009 S.N shkoi tek Sh.i dhe i tha se 15.000 eurot duhej t'i paguheshin atij, përndryshe, "ai do të tërhiqej dhe Sh.it do t'i duhet të ketë punë me T." Ai u tërhoq. Sk.i i tha Sh.it "nga tani e tutje, ti nuk ke më punë me mua, do të kesh punë me T.in".

Sh.i shkoi të takohej me S.Kn, miku i T.it, dhe iu lut atij dhe i kërkoi nëse ishte e mundur që ai të hynte në kontakt me T.in ose Sk.n për të zgjatur afatin e borxhit në shumën 15.000 euro deri në korrik të vitit 2009. S.i i tha Sh.it se ai kishte folur me T.in dhe duket se T.i kërkon 3.000 euro për shtyrjen e afatit deri më 1 korrik. S.i i tha Sh.it se 3.000 eurot ishin për T.in.

Sh.i administronte një dyqan dhe po fillonte sezoni i shitjeve; ai u pajtua me këtë, sepse ishte në situatë të vështirë. S.i i tha Sh.it se automjeti Golf 4 që kishte Sh.i, duhej t'i lihej atij si garanci. Sh.i u pajtua ta barte pronësinë e automjetit në emrin e S.it dhe, në rast se ai nuk arrinte t'i paguante 3.000 eurot deri në 1 korrik, S.i do ta shiste veturën dhe do të mbante 3.000 euro, ndërsa Sh.i do të mbante pjesën e mbetur. Sh.i mori automjetin, hartoi marrëveshjen e shitjes, dhe dokumentet e automjetit u kaluan në emrin e S.it dhe S.i i dha atij një autorizim që vërtetonte se ai mund ta voziste automjetin deri më 1 korrik. Regjistrimit të automjetit për vazhdim i arrinte afati më 25 ose 26 qershor. Sh.i ia dha dokumentet e automjetit të njëjtit personi i cili kishte bërë kontratën e shitblerjes për të rinovuar regjistrimin e automjetit. Ai gabimisht e barti automjetin përsëri në emrin e Sh.it. S.i e zbuloi këtë dhe, së bashku me Sh.in, shkoi tek i njëjti person, i cili bëri një kontratë tjetër shitblerjeje, por ai i tha: "Mbaje në emrin tënd, pasi vetëm pak ditë kanë mbetur deri më 1 korrik." Sh.i kishte një mik në Tiranë, i cili i kishte premtuar ta ndihmonte dhe t'i jepte para, kështu që ai shkoi dhe ndërkohë që Sh.i ishte në pritje të tij, S.i erdhi në Tiranë me 3-4 njerëz. Ishte e premtë, ora ishte 13.15 ose 13:30, dhe ata ia morën atij automjetin me forcë. Sh.i nuk bëri kallëzim për këtë në polici, pasi mendoni se automjeti do të ndalej në kufi gjithsesi, sepse makina ishte e regjistruar në emrin e tij. Megjithatë S.i e solli automjetin në Kosovë dhe ia shiti të njëjtit personi që e kishte

regjistruar makinën dhe kishte bërë kontratën. Ai gjithashtu bëri kallëzim për Sh.in në polici me pretendimin se ai kishte falsifikuar dokumentet e automjetit.

Kur dëshmoi më 4 gusht 2009, Sh.M deklaroi, *“S.i më tha, unë mund ta bëj këtë për ty. Ai bisedoi me të, T.Kjn, i kërkoi 7.500 euro të tjera (krahas shumës 15.000). Meqenëse isha në situatë të vështirë, pranova. S.i më kërkoi ta bart pronësinë e Golfit në emrin e tij si garanci.”*

Gjatë shqyrtimit gjyqësor Sh.M deklaroi se shuma 7.500 euro ishte vlera e veturës.

Më 14 tetor 2009, më tej, Sh.i dëshmoi *“Unë isha i detyruar të shkoj tek shoku i T.it i quajtur S.K dhe t'i kërkoj S.it të takonte T.in dhe ta shtynte kredinë dhe kamatën time. S.i shkoi tek T.i dhe më tha po, ai do ta shtyjë pagesën me 2 muaj të tjerë, nga 01 maji 2009 deri në 1 korrik 2009, por për dy muajt e fundit, maj dhe qershor, je i detyruar të paguash shumën prej 3.000 eurosh vetëm në emër të kamatës, kjo do të thoshte që unë kisha për të paguar 15% kamatë, ndërsa borxhi kryesor dhe kamata që i detyroheshka ishte 15.000 euro. Për këtë arsye, borxhi u rrit dhe u bë 18.000 euro. S.K kërkoi ta garantonte atë se unë do të isha në gjendje t'ia shlyeja borxhin dhe kamatën, ndërsa unë isha i detyruar t'i paguaja S.it shumën prej 3.000 eurosh dhe T.it 15.000 euro”.*

Kur u pyet nga kryetarja e trupit gjykues se pse më 4 gusht 2009 Sh.M deklaroi ndryshe *“Unë isha i detyruar t'i paguaja 7.500 të tjera T.it,”* ndërsa më 14 tetor 2009 Sh.i deklaroi, *“Unë isha i detyruar t'i paguaja 3.000 të tjera S.Kt”?*

Sh.M: Ndoshta vetëm për shkak se unë e di këtë, mendoj se edhe gjykata e di. Bashkë me S.in, ne e vlerësuam kerrin në çmimin 7.500 euro. Sa i përket 15.000 eurove, S.it tha, “ti duhet të paguash 3.000 euro, që është përsëri 10%, 1.500 euro çdo muaj.

Kryetarja e trupit gjykues: Kujt?

Sh.M: S.i tha se ai kishte folur me T.in, të dy muajt nga 1 maji deri më 1 korrik, S.i tha se ne duhej t'i paguanim 3.000 euro T.it.

Kryetarja e trupit gjykues: Çfarë do të thotë “ne”?

Sh.M: Unë.

Kryetarja e trupit gjykues: Pra, S.i nuk ka marrë asnjë para për ndërmjetësimin dhe ai nuk kërkoi para?

Sh.M: Jo, përveç automjetit që u mor me forcë.

Kryetarja e trupit gjykues: Ju thatë se makina u mor si garanci për 3.000 euro?

Sh.M: Marrëveshja që bëra me S.in ishte, në rast se unë nuk arrija t'i paguaj 3.000 euro, në një rast të tillë, ne do të shisnim kerrin, ai merr 3.000 euro dhe paratë e tjera më mbeteshin mua.

Sh.i shkoi në Tiranë me automjetin Golf 4. Një shok i premtoi Sh.it se do t'i jepte para për ta ndihmuar dhe Sh.i shkoi për të marrë paratë. Ndërsa ishte duke pritur shokun, S.i shkoi në Tiranë me 3 njerëz dhe ia mori veturën Sh.it.

Prokurori: Cila ishte çështja përfundimtare me borxhin total prej 15.000 eurosh që i detyroheshit T.it apo S.Nt, plus 3.000 euro? A i paguat?

Sh.M: Sa i përket 3.000 eurove për të cilat u shty afati, S.K më mori kerrin, 15.000 eurot mbetën. Nga 1 korriku fillon sezoni i shitjeve, nuk më kujtohet nëse ishte fundi i gushtit apo fillimi i shtatorit, por unë i dhashë 15.000 euro S.Nt dhe ai tha se do t'ia jepte T.it, borxhi u pastrua. S.i nuk i pagoi kurrë këto para për kerrin. Borxhi u pagua nga unë.

Sipas mendimit të gjykatës, deklaratat e të dëmtuarit Sh.M përmbajnë shumë parregullsi, kundërthënie, papajtueshmëri, kontradikta dhe mospërputhje në lidhje me të pandehurit e përmendur në Akuzën I të Aktakuzës.

Dëshmitari B.M

Ai dëshmoi gjatë shqyrtimit gjyqësor më 9 dhjetor 2013 dhe konfirmoi deklaratat e tij të mëparshme të dhëna në prokurori më 21 tetor 2009 dhe në shqyrtimin e parë më 14 shtator 2011.

Më 9 dhjetor 2013, B.M tha se gjatë vitit 2009 ishte Sh.M ai që kërkoi borxh. Dëshmitari nuk e kishte këtë shumë parash. Me kërkesën e Sh.Mt, B.M i kërkoi borxh S.Kt. S.i i kishte marrë me qira një lokal dëshmitarit B.M. Sh.i dhe B.i kontaktuan S.Kn. S.K i dha Sh.Mt shumën 7.000 euro pa kamatë. Si garanci për borxhin, S.K mori automjetin e Sh.Mt dhe ia barti S.Kt të drejtat e veturës së Sh.it. S.i nuk e mori automjetin e tij nga

Sh.i, ai vetëm e barti atë në emrin e tij dhe ia dha automjetin Sh.Mt për ta vozitur. Dëshmitari B.M nuk ishte i pranishëm kur paratë iu dorëzuan Sh.it. Afati i fundit për kthimin nga Sh.i të borxhit që i kishte marrë S.it, ishte brenda një muaji. Atëherë Sh.i bëri disa nën-marrëveshje dhe e barti automjetin përsëri në emrin e vet dhe iku në Shqipëri. Ata shkuan në Shqipëri dhe e takuan Sh.in në Tiranë. Sipas dëshmitarit, Sh.M ia dha çelësat vullnetarisht S.Kt. Kur u pyet nga Gjykata:

Kryetarja e trupit gjykues: Në vitin 2009, në marrjen tuaj në pyetje për herë të parë më 21 tetor, ju i thatë prokurorisë se borxhi ishte 7.500 euro dhe më pas, më 14 shtator të vitit 2011 në faqen 12, ju thatë se shuma ishte 7.000 euro dhe sot ju thoni të njëjtën gjë, se ajo ishte 7.000 euro. Pse e keni ndryshuar mendjen tuaj, çfarë ka ndodhur nga viti 2009 deri në vitin 2011?

B.M: Dallimi në mes tani dhe atëherë është se ai në të vërtetë e vlerësoi automjetin e tij në shumën 7.500 euro.

Kryetarja e trupit gjykues: Por ju nuk e thatë këtë para trupit gjykues të mëparshëm, ju thatë se borxhi ishte 7.000 euro dhe ju nuk përmendët asgjë në lidhje me automjetin.

B.M: Jo, unë nuk e përmenda automjetin në fjalë dhe pastaj deklarova se ai në fakt ia barti pronësinë e automjetit S.Kt dhe automjeti u vlerësua në çmimin e 7.500 eurove.

Dëshmia e dëshmitarit B.M ishte koherente dhe përputhej me deklaratën e dhënë nga i pandehuri S.K.

Të pandehurit S.N, M.K, T. K dhe S.K

S.N

S.N deklaroi se Sh.M i ishte prezantuar si agjent i SHIK-ut (Agjencisë Kosovare të Inteligjencës). S.N mohoi çdo lidhje të pretenduar biznesi me vëllezërit K. apo S.Kn. Ai mohoi t'i kishte dhënë ndonjë borxh të dëmtuarit. Ai mohoi të kishte hartuar ndonjë marrëveshje me Sh.Mn më 1 nëntor 2007 në lidhje me një borxh prej 23.000 eurosh me kamatë. Ai pranoi se i kishte dhënë të dëmtuarit letër-njoftim, por jo duke marrë apo duke dhënë para. S.N deklaroi se B.C kishte shkuar tek ai dhe i tha atij se ai ishte garant për borxhin që do të merrej nga Sh.M. Be. tha se ai formalisht kishte nevojë për një garantues tjetër. Sh.M shfrytëzoi rastin për të bërë diçka me letër-njoftimin e tij.

M.K.

M.K. deklaroi se kurrë nuk e kishte dëgjuar emrin Sh.M më parë. Ai mohoi t'i kishte marrë borxh S.Nt, me qëllim që t'ia japte Sh.Mt. M.i kujton se gjatë një bisede me N.n dhe babanë e tij, vëllai i tij i ndjerë, N. K., i kishte thënë se një person me emrin K. i detyrohej atij 10.000 euro. Katër vjet më vonë ky person, që do të thotë Sh.M, i ktheu M.Kjt paratë që ia kishte marrë N.s, pa asnjë kamatë.

T.K

T.K deklaroi se nuk kishte asnjë lidhje me Sh.Mn. Ai nuk i kishte huazuar atij para dhe nuk dinte që S.N t'i kishte dhënë para atij.

S.K

S.K dëshmoi se ishte 13 maj 2009 kur ai ishte takuar për herë të parë me Sh.Mn. Sh.M dhe B.M shkuan tek lokali i Sk.it dhe i kërkuan të holla. S.i kurrë nuk e kishte njohur Sh.in më parë. Kur dëshmoi para prokurorisë më 19.10.2009, S.K tha se B.M kishte shkuar së bashku me Sh.in në lokalin e tij. B.i i kërkoi S.it t'i jepte Sh.it 5.500 euro¹ borxh me afat 1 muaj. Prandaj, atë natë S.i i dha Sh.it 7.500 euro, me kushtin që ato të kthehen brenda 1 muaji pa asnjë kamatë.

Në shqyrtimin kryesor, S.i deklaroi se i dha Sh.Mt një borxh prej 7.000 eurosh pa kamatë. Si garanci për borxhin, S.i K mori veturën Golf 4 të Sh.Mt dhe i barti të drejtat e veturës tek S.K. Ata bënë autorizimin në gjykatë që Sh.i mund ta voziste makinën për një muaj dhe, në rast se ai nuk i kthente paratë, vetura do t'i kalonte S.it, pasi ajo ishte bartur tashmë në emrin e tij. Sh.M falsifikoi dokumentet e makinës dhe e barti veturën sërish në emrin e tij. Tre a katër ditë para përfundimit të afatit të marrëveshjes, S.i e takoi Sh.in në restorant Mullini dhe i kërkoi atij t'ia kthente paratë të nesërmen. Sh.i i tha se do t'ia kthente paratë të nesërmen. Deri atë ditë S.i nuk kishte dijeni se Sh.i e kishte bartur veturën në emrin e tij. Kur S.i e pyeti nëse Sh.i mund t'i mblidhte të gjitha paratë për t'ia kthyer atij, Sh.i i tha se do të shkonte në Shkup dhe kunati i tij nga Suedia do t'i sillte paratë. Pikërisht atëherë S.i kuptoi se Sh.i e kishte bartur veturën në emrin e tij, pasi ajo kishte qenë pa regjistrim për 10 ditë. Të nesërmen S.i e takoi Sh.Mn afër një

¹ Për mendimin e Gjykatës, Shuma 5.500 euro e përcaktuar në dëshminë e S.Kt të dhënë në Prokurori më 19.10.2009, duhet të jetë gabim. Kjo shumë 5.500 euro nuk ishte përmendur nga i pandehuri në ndonjë dëshmi tjetër.

auto-shkolle në Prizren. Aty ishin A.H, B.M dhe një person i quajtur Mu. nga Dushanova. Më 30 qershor S.i hartoi një kontratë interne me Sh.in. Në bazë të kësaj kontrate, Sh.i ishte i detyruar t'i kthente paratë deri më 1 korrik dhe, nëse nuk i kthente, t'i jepte S.it automjetin. Sh.M shkoi në Shqipëri. S.i mori me vete komandantin e policisë, Z.S, dhe ata shkuan në kufirin me Shqipërinë për të verifikuar nëse Sh.M kishte kaluar kufirin me automjetin. Ata mësuan se një ditë më parë, në ora 15:00, Sh.i kishte kaluar kufirin shqiptar. S.i së bashku me B. M shkuan në Shqipëri. Atje ata takuan Sh.in. S.i i kërkoi Sh.it paratë dhe Sh.i i dha atij veturën. S.K e shiti veturën për 6,300 euro, që ishte më pak se borxhi i pashlyer dhënë Mi.t.

Gjendja faktike

Sh.M nga Prizreni është tregtar. Ai kishte në pronësi një dyqan privat dhe kryesisht punonte me mallra të tekstilit. Në vitin 2007 Sh.i kishte një dyqan, por në vitin 2009 ai kishte tre dyqane. Në muajin nëntor 2007, Sh.M i kërkoi S.Nt 23.000 euro për të hapur një dyqan. S.N i tha Sh.it se ai nuk kishte para për t'i dhënë atij, por ai do t'i gjente paratë për t'u kthyer me kamatë. Ata hartuan një marrëveshje me shkrim. Sh.i mori paratë nga S.N në shumën 23.000 euro, me kamatë mujore 11%, ose 2.500 euro në muaj. Sh.i i pagoi Sk.it 2.500 euro kamatë në muaj për tre muaj.

Sh.M pretendoi se për t'i marrë borxh S.Nt, ai nuk kishte qenë i detyruar me përdorimin e dhunës nga ndokush. Sh.i nuk i tregoi S.Nt se është në situatë të vështirë financiare. Ai kërkoi para vetëm për të hapur një dyqan. Ai nuk kishte qenë i detyruar nga përdorimi i dhunës nga ndokush për t'i marrë hua para S.Nt.

Vëllezërit K. nuk kishin rol në huazimin e parave nga S.N. Sh.M nuk kishte “marrëveshje për huazimin e parave me kamatë” me vëllezërit K.. Sh.M gjithashtu pranoi faktin se M.K ishte burgosur dhe kryente dënimin për një vrasje.

Si Sh.M, ashtu dhe vëllezërit K. deklaruan se nuk kishte pasur bartje të parave prej tyre tek i dëmtuari; me fjalë të tjera, ata nuk i huazuan para atij.

M.K nuk mund as të përfshihej në aktivitete kriminale në atë kohë (krahasoni eksponatin C10).

T.K deklaroi se nuk kishte asnjë lidhje me Sh.Mn; T. nuk i kishte huazuar atij asnjë para dhe nuk dinte që atij t'i ishin dhënë para nga S.N.

Kur u pyet nga mbrojtësja K.K., faqja 4 e procesverbalit të datës 14 mars 2014:

A do të bashkoheshit me ndjekjen penale kundër T.Kjt dhe M.Kjt?

Sh.M: Jo, sepse në rastin tim ata nuk janë fajtorë.

Aktakuza e trajton S.Kn si njëri prej të pandehurve të përfshirë në detyrimin e të dëmtuarit, duke vepruar si anëtar i grupit të pretenduar. Sipas Aktakuzës, i pandehuri S.K u përfshi për të shtyrë afatin e shlyerjes së borxhit dhe të kamatave, por ai i kërkoi 3.000 euro të dëmtuarit si shpërblim për ndërmjetësimin e bërë midis tij dhe të pandehurit T.K. Pretendohet se i dëmtuari nuk kishte mundësi për të mbuluar kërkesa të tilla ndaj S.Kt dhe ky i fundit mori veturën e tij Golf 4.

Rrethana më lart nuk pasqyrojnë të vërtetën. Sipas dëshmitarit B.M, ishte vetë Sh.M ai i cili kërkoi një borxh prej 7.000 eurosh. Dëshmitari nuk e kishte këtë shumë parash. B.M e kontaktoi atë me shokun e tij S.K. Paratë iu dhanë Sh.Mt. nga S.K. pa kamatë. Si garanci për borxhin, S.K. mori veturën e Sh.Mt. dhe Sh.i. i barti të drejtat e veturës tek S.K. Ndërkohë, kur erdhi koha e shlyerjes së borxhit, Sh.M. shkoi në Shqipëri me veturë. Duket qartë se Sh.M i falsifikoi dokumentet e veturës dhe e barti veturën përsëri në emrin e tij. Për këtë Sh.M u padit (shih eksponatet C3 dhe C13). Sipas dëshmitarit, Sh.M. ia dha çelësat S.Kt vullnetarisht. Në kufi, B. M dhe S.K e kallëzuan Sh.M. në polici dhe pronësia e automjetit u bart përsëri tek S.K. Dëshmia e këtij dëshmitari, B.M, ishte koherente dhe përputhej me deklaratën e dhënë nga i pandehuri S.K.

Nuk ka prova që S.i ishte “anëtar i grupit” në kuptimin e parashikuar nga neni 267 paragrafi 2 i KPK-së. S.K nuk po vepronte në emër të S.Nt dhe vëllezërve K.. S.K tha se ai e shiti atë makinë për 6.300 euro, që ishte më pak se borxhi i pashlyer që i ishte dhënë Sh.Mt.

Neni 267 i KPK-së shpall:

(1) Kushdo i cili me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme përdor forcën apo kërcënimin e rëndë për ta detyruar personin tjetër që të veprojë apo të mos veprojë në dëm të pasurisë së vet a të pasurisë së personit tjetër dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit duke përdorur ndonjë armë ose mjet të rrezikshëm apo

rezulton me dobi të madhe pasurore, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Vepra penale e detyrimit, në pajtim me paragrafin 1, ekziston kur kryerësi, duke përdorur forcën apo kërcënimin serioz, e shtrëngon / e detyron personin tjetër të bëjë diçka, apo të mos bëjë diçka, në dëm të pasurisë së tij ose të personave të tjerë, me qëllim sigurimin për veten ose një person tjetër të përfitimit të paligjshëm të pasuror.

Vepra penale e detyrimit nënkupton synimin e autorit të krimit për të siguruar për veten ose për një person tjetër përfitim të paligjshëm pasuror. Pa këtë synim, nuk ka vepër penale.

Akti i kryerjes së këtij veprimi kriminal është përdorimi i forcës ose kërcënimit serioz. Forca ose kërcënimi duhet të zbatohet me qëllimin për ta shtrënguar / detyruar një person të bëjë diçka, apo të mos bëjë diçka, në dëm të pasurisë së tij ose të personave të tjerë.

Pra, i dëmtuari detyrohet / shtrëngohet të kryejë një veprim të caktuar, ose të mos e kryejë atë, që do të ketë pasoja të dëmshme mbi pasurinë e tij ose të të tjerëve.

I dëmtuari Sh.M nga fillimi i shqyrtimit gjyqësor pati papajtueshmëri në dëshmitë e tij. E vetmja gjë që nuk ka ndryshuar në të gjitha dëshmitë e Sh.Mt ishte shuma e 23.000 eurove të huazuara nga S.N.

Prokuroria nuk i ka dhënë gjykatës ndonjë provë që do të vërtetonte sa ishte përqindja e kamatës. Nuk ka prova për të mbështetur deklaratat e vakëta të të dëmtuarit. Shënimet (kopjet) e ofruara bashkë me aktakuzën, ishin bërë kryesisht nga vetë Sh.M. E vetmja shkresë, kinse e nënshkruar nga S.N, nuk ishte origjinale. Duke pasur parasysh se i pandehuri e mohoi nënshkrimin e tij, gjykatës nuk i lejohet ta marrë parasysh këtë provë. Duke qenë në dijeni të faktit të praNr nga Sh.M se ai ishte duke marrë kredi me qëllim që të paguante borxhet e tij të mëparshme dhe se ky ishte recepti i tij për jetën dhe problemin financiar, është shumë e vështirë të mbështetesh në deklaratën e tij se ai ishte viktimë e detyrimit ose kontraktimit të përfitimit joproporcional.

I dëmtuari Sh.M pranoi se asnjëri nga të pandehurit nuk kishte pasur dijeni për gjendjen e tij të vështirë ekonomike. Edhe po të supozohet besueshmëria e tij lidhur me faktin se ai vërtet huazoi para nga S.N, T.K dhe M.K, nuk ka asnjë element të veprës penale të kontraktimit për përfitim joproporcional pasuror, të përcaktuar në nenin 270 të KPK-së.

Sh.M e paraqiste veten si një biznesmen i suksesshëm dhe kështu u perceptua nga të gjithë. Nuk pasi asnjë shenjë të vetme të mospërvojës apo të paaftësisë së tij.

Sipas mendimit të gjykatës, deklaratat e të dëmtuarit përmbajnë shumë parregullsi, mospërputhje, kundërthënie, kontradikta dhe mospërputhje në lidhje me të gjithë të pandehurit.

Nuk u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit S.N, T.K, M.K dhe S.K përdorën forcë ose bënë kërcënime serioze ndaj të dëmtuarit Sh.M, ose e detyruan të njëjtin të vepronte në një mënyrë që do të dëmtonte pasurinë e tij.

Nuk u bë asnjë përshkrim i mënyrës se si u përdorën forca apo kërcënimet dhe kur ndodhën këto. Sigurisht dikush mund të bëjë një pyetje tjetër, nëse S.N, vëllezërit K. dhe S.K vepruan në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë. Nga Aktakuza është e pamundur të mësohet diçka në lidhje me këtë. Duhet arritur në përfundimin se nuk u individualizua pozita e secilit prej të pandehurve, dhe nuk u pasqyrua kontributi i tyre në veprën penale.

Sipas mendimit të gjykatës, nuk ka pasur grup të organizuar, nuk ka pasur asnjë planifikim, nuk ka pasur detyra individuale dhe asnjë veprim të koordiNr sipas një plani operacional. Dispozita përcakton faktin e të qenit anëtar i një grupi si rrethanë rënduese dhe për këtë arsye neni 267 paragrafi 2 vendos një dënim më të rëndë. Përkufizimi i një grupi duhet të bazohet në elemente objektive. Prokuroria nuk shpjegon se çfarë lloj grupi u formua nga të pandehurit, se në çfarë marrëveshje ishte e bazuar kjo, cilat ishin rregullat e funksionimit të tij. A përdorën ata forcë dhe kërcënime bashkërisht apo veç e veç? Nuk ka prova lidhur me rrethanën që vëllezërit K., S.K dhe S.N vepruan si një grup në kryerjen e kësaj vepre penale, ose tentuan ta kryejnë këtë vepër.

Edhe po të supozohet besueshmëria e Sh.Mt lidhur me faktin se ai vërtet i huazoi këto para nga S.N, T.K, M.K dhe S.K, nuk ka asnjë element të veprës penale të kontraktimit për përfitim joproportional nga pasuria, sipas përcaktimit në nenin 270 të KPK-së. Sh.M e paraqiste veten si biznesmen i suksesshëm dhe kështu u perceptua nga të gjithë. Nuk kishte asnjë shenjë të vetme të mospërvojës ose të paaftësisë së tij.

Akuza II e Aktakuzës

Në dëshminë gjatë shqyrtimit gjyqësor më 6 dhjetor 2013, Sh.M deklaroi se më 1 dhjetor 2007 ai mori një borxh në shumën 10.000 euro nga V.K, me kamatë 10% për qind. Sh.i i pagoi V.Kt kamatë për 3 muaj, që do të thotë 3.000 euro. Meqë Sh.i nuk ishte

në gjendje ta paguante kamatën, V.i e prezantoi atë me Ar. B. Sh.i mori 15.000 euro të tjera nga Ar.i. Nga V.i 10.000 eurot u bartën në emër të Ar.it, kështu që shuma e përgjithshme që i detyrohej Ar.it ishte 25.000 euro dhe Sh.i filloi t'i paguante Ar.it kamatën 10% në muaj. Sh.i pagoi kamatë për 4 ose 5 muaj, deri në korrik apo gusht të vitit 2008. Më tej, Sh.M deklaroi se ai i kishte kërkuar Sh. S 25.000 €. She.i i tha atij: *“Unë nuk i kam ato para, por mund të t'i gjej përmes një miku, A.B, i cili do të t'i japë këto para me kamatë 10%.”* Sh.i mori para nga She.i me kamatë mujore 10%. Për këtë shumë Sh.i i pagoi She.it kamatë për 12 muaj, 2.500 euro çdo muaj, dhe She.i i kërkoi Sh.it që ai t'ia jepte paratë Af.it.

Prokurori: Çfarë ndodhi me borxhin që ju i detyroheshit Ar.it?

Sh.M: Ne u mblodhëm, të katër ne, dhe unë i dhashë atij ngastrën e tokës dhe borxhi u pastrua.

Prokurori: Si ia dhatë ngastrën dhe sa ishte sipërfaqja e saj?

Sh.M: Ngastra ishte 6 ari.

Prokurori: Pronë e kujt ishte kjo?

Sh.M: E babait tim. Ne negociuan shumë 87.500 euro për çmimin e tokës. Unë u detyrohesha 70.000 euro Af.it dhe Ar.it. Ata më dhanë 17.500 eurot e mbetura, të cilat ia dhashë nënës time.

Prokurori: A ishte kjo ngastër në emër të Sh. S?

Sh.M: Kur e bleu babai im, ajo nuk ishte as në emër të She.it, por ishte në emër të një personi tjetër nga i cili e kishte blerë She.in. Pastaj She.i e regjistroi tokën në emër të tij.

Prokurori: Pra, kjo do të thotë se ngastra e tokës nuk ishte e babait tënd, por e She.it?

Sh.M: Siç kam deklaruar më parë, ne e blemë atë tokë në bazë të një marrëveshjeje me gojë. Megjithatë, me She.in nuk u bë asnjë kontratë shitblerjeje, sepse ne ishim kushërinj.

Prokurori: Sa paguat dhe kush e bleu atë?

Sh.M: Babai im, në shumën 100.000 marka gjermane.

Prokurori: Çfarë bëtë me këtë shumë 87.500?

Sh.M: Pagova borxhin për V.in, Ar.in dhe She.in në emër të Af.it. 17.500 eurot e mbetura ia dhashë nënës time.

Prokurori: A të detyruan ose shtrënguan V.i, Ar.i dhe Af.i ta shisni këtë tokë, apo a të kërcëni ata; nëse po, kush, si dhe kur?

Sh.M: Ne negociuam për këtë tokë në Paqarizi Petrol. Ar.B dhe V.K më kërcëni dhe më detyruan ta bëj këtë. Unë isha i detyruar ta bëj këtë, t'ua jap atyre këtë ngastër toke, për të pastruar borxhin.

Prokurori: Në çfarë forme ju kërcëni konkretisht, me fjalë a veprime, apo si?

Sh.M: Ata nuk përdorën forcë. Ata më kërcëni duke më thënë, "Ne do të të vrasin ose do të kidnapojmë djalin tënd derisa të na kthesh paratë," këto lloj fjalësh.

Prokurori: A të kërcënoi Af.i?

Sh.M: Jo. Unë e takova Af.in për herë të parë kur po negociohej çmimi i tokës.

.....

Në dëshminë e dhënë para policisë më 04.08.2009, Sh.M deklaroi se personi tjetër të cilit ai i huazoi para ishte V.K. Më 01.12.2007, ai huazoi prej tij 10.000 euro me kamatë mujore 10%. Ai i pagoi atij 1.000 euro këste mujore për dy muaj. Më 01.02.2008, ai huazoi nga V.i një shumë tjetër prej 15.000 eurosh, me kamatë 10%, dhe shuma e përgjithshme u bë 25.000 euro. Ai i pagoi atij 2.500 euro këste mujore deri në maj të vitit 2008.

Pas kësaj, me ndërmjetësimin e V.Kt, Sh.i huazoi para nga ortaku i V.it, Ar.B, një shumë tjetër prej 10.000 eurosh me kamatë 10%. Sh.i i pagoi Ar.B këste mujore në shumën 3.500 euro deri në shtator 2008.

Në të njëjtën kohë, krahas Ar.B, ai huazoi edhe nga i afërmi i tij, A.B, shumën prej 25.000 eurosh me kamatë mujore 10%. Sh.i i pagoi këtij të fundit 2.500 euro këste mujore nga data 22.09.2007 deri në datën 31.09.2008.

Këta të afërm, Ar. dhe A.B, e detyruan Sh.in, të dy ata, të shesë në Hotel MENA ngastrën me sipërfaqe 6 ari për 87.500 euro dhe Sh.i e barti pronësinë e kësaj ngastre në emër të A.B. Sh.i tashmë u detyrohej atyre 70.000 euro, kështu që ata i kthyen atij 17.500 euro para të gatshme, të cilat Sh.i ia dha nënës së tij, sepse ngastra ishte në emër të babait të tij të ndjerë.

Kur dëshmoi para prokurorit publik më 3 nëntor 2009, Sh.i deklaroi se Sh. N. S nga Prizreni i detyrohej një shumë prej 100.000 DM babait të tij të ndjerë L. Meqë Sha.i nuk ishte në gjendje ta paguante shumën, në vend të saj Sha.i i dha si kompensim babait të tij L. një ngastër me sipërfaqe 6 ari në vendin e quajtur Jagllenica. Kjo ngjarje ka ndodhur pas luftës së vitit 1999 apo 2000. Vlera e ngastrës u llogarit në rreth 100.000 DM. Gjatë kësaj marrëveshjeje ishin të pranishëm nëna e Sh.it, Va., dhe vëllai i tij, VII. M. Ata nuk bënë asnjë dokument të shkruar, por vetëm marrëveshje gojore, pra kjo ngastër ishte pronë e Sh. S dhe nuk u bart në emër të babait të Sh.it. Në shtator të vitit 2008, Sh.i u thirr në telefon nga Sha.i dhe Af.i për t'u takuar me ta, dhe ata u takuan në pompën e gazit "Paqarizi". Ata i kërkuan Sh.it të paguante borxhin dhe ai i detyrohej Af.it 30.000 euro, si gjithëgjë, ndërsa kamata ishte paguar më herët. Gjithashtu, ai i detyrohej Ar.it 40.000 euro, sepse përsëri kamatën e kishte paguar më herët. Të dyve Sh.i u detyrohej vetëm gjithëgjënë. Në atë vend i pranishëm ishte edhe Sha.i, i ftuar nga Af.i dhe Ar.i. Sh.i nuk ishte në gjendje t'ua shlyente borxhin Af.it dhe Ar.it. Ata morën informacionin se Sh.i kishte në pronësi në vendin e quajtur Jagllenica një ngastër me sipërfaqe 6 ari, dhe ata i kërkuan që, në vend të borxhit, ai t'u jepte atyre një ngastër si kompensim. Sh.i ra dakord, por ata sollën një përfundim lidhur me çmimin e ngastrës në shumën 87.500 euro. Af.i dhe Ar.i ranë dakord me këtë çmim. Meqë Sh.i u detyrohej të dy atyre 70.000 euro, shumën tjetër të parave në emër të çmimit të ngastrës, 17.500 euro, Af.i ia dha në dorë Sha.it, pasi ngastra ishte e regjistruar në emrin e tij, dhe Sh.i së bashku me Sha.in shkuan te nëna e Sh.it, Va., dhe ia dhanë paratë asaj.

Ndërsa në dëshminë e dhënë më 14 tetor 2009, Sh.M deklaroi se më 01.12.2007 ai i mori personit me emrin V.K, një borxh në shumën 10.000 euro, me kamatë mujore 10%, ose 1.000 euro në muaj. Afati i fundit për të paguar paratë ishte 3 muaj, ose deri në datën 01.02.2008. Ai nuk e njihte V.in, por e njohu përmes një personi me emrin F. B.

Sh.i nuk qe në gjendje ta paguante gjithëgjënë në datën e parashikuar. V.i i tha Sh.it se është një person tjetër i cili jep para me fajde dhe ai është Ar.B. Së bashku me V.in, ata shkuan tek Ar.i në Suharekë. Më 01.02.2008, Sh.i mori një borxh prej Ar.it në shumën 15.000 euro, me kamatë mujore 10%, ose 1.500 euro në muaj. V.i dhe Ar.i ranë dakord që borxhi dhe kamatat e V.it t'i paguheshin Ar.it nga tani e tutje. Sh.i i mori borxh V.it

10.000 euro, ndërsa Ar.it 15.000 euro, prandaj shuma e përgjithshme e gjithëgjësë ishte 25.000 euro dhe 10% e kamatës, ose 2.500 euro në muaj.

Për më tepër, ai vazhdoi t'i paguajë Ar.it vetëm kamatën 2.500 euro, duke filluar nga data 01.02.2008 deri në datën 01.05.2008, dhe pagesa ishte për 3 muaj. Kur afati i fundit u afrua, që do të thotë 1 maj 2008, Sh.i nuk kishte para për t'i shlyer borxhin Ar.it, prandaj ai u detyrua përmes ndërmjetësit të quajtur V., t'i marrë borxh Ar.it 10.000 euro të tjera. Sh.i i mori 10.000 eurot e fundit më 1 maj 2008, përsëri me kamatë 10%. Borxhi total u bë 35.000 euro me 10% kamatë mujore, ose 3.500 euro në muaj, duke filluar nga data 1 maj 2008. Afati i fundit i shlyerjes së borxhit ishte 1 shtator 2008.

Më 22.09.2007, Sh.M.. mori një borxh edhe nga A.B. nga Suhareka, në shumën 25.000 Euro, me kamatë mujore 10% ose 2.500 euro në muaj. Ai i pagoi Af.it vetëm kamatën për 10 muaj me radhë, nga data 22.09.2007 deri në datën 31.09.2008. Gjithëgjënë nuk e ka paguar.

Ndërkohë, meqë Sh.i. nuk ishte në gjendje t'u paguante paratë të dy atyre, Ar.i. dhe A.B. shkuan tek ai dhe i kërkuan Sh.it të paguante detyrimet e tij. Ata dëgjuan se Sh.i kishte në pronësi një ngastër prej 6 ari, të ndodhur në lagjen Jagllenica afër restorant "Mena".

Sh.i e shiti ngastrën për të paguar borxhin e marrë nga Ar.B dhe A.B. Ngastra u shit më 31.09.2008. Në atë kohë Sh.i i detyrohej Ar.it 35.000 euro për gjithëgjënë e borxhit, plus 10.000 euro për kamatën, pra, gjithsej 45.000 euro. Sh.i i detyrohej edhe Af.it 25.000 euro. Nuk kishte kamatë për t'i paguar atij. Prandaj, shuma e përgjithshme e të dy borxheve ishte 70.000 euro. Ngastra e Sh.it ishte 87.500 euro, prandaj pjesën tjetër të parave, që do të thotë 17.500 euro, Ar.i ia dha Sh.it dhe këtë shumë Sh.i ia dha nënës së tij.

Kur Sh.i u shiti ngastrën Ar.it dhe Af.it, ata përpiluan një kontratë me shkrim. Menjëherë ata e bartën ngastrën në emër të tyre, pasi që ajo tokë ishte e regjistruar në emrin e Sh. S. Kontrata u nënshkrua nga Sh. S. dhe A.B.

Sipas mendimit të gjykatës, deklaratat e të dëmtuarit përmbajnë shumë parregullsi, papajtueshmëri, kundërthënie, kontradikta dhe mospërputhje.

Dëshmitari F.B

Dëshmitari F.B u dëgjua në gjykatë më 9 dhjetor 2013. Kur u pyet nga Prokurori dhe kryetarja e trupit gjykues, në shumicën e rasteve ai u përgjigj, nuk e mbaj mend.

Versioni i deklaratave të tij të dhëna në shqyrtimin e parë më 14 shtator 2011 dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor janë shumë ndryshe nga versioni i dhënë në fazën e shqyrtimit paraprak. Në dëshminë e dhënë në prokurori më 02.11.2009, dëshmitari përmendi në deklaratat e tij se Sh.M mori nga V.K një borxh në shumën 10.000 euro, me kamatë 10% në muaj. Gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor më 14 shtator 2011, dëshmitari deklaroi se nuk ishte i sigurt në lidhje me shumën e borxhit të marrë nga Mi.. Ajo ishte 5.000 ose 10.000 euro që Sh.i ia mori borxh V.it. Ishte Sh.i ai i cili i kërkoi paratë, sepse atij i nevojiteshin për të blerë mallra. Ai nuk mban mend në lidhje me përqindjen e kamatës së borxhit.

Sipas mendimit të gjykatës, dëshmitari nuk ishte i besueshëm.

Dëshmitari Sh.S

Dëshmitari Sh.S u dëgjua në gjykatë më 16 janar 2014. Dëshmitari deklaroi se ai nuk shiti dhe as bleu ndonjë ngastër toke nga babai i Sh.Mt, i quajtur L. Mi.. Dëshmitari i kishte një borxh babait të Sh.it, i detyrohej atij një shumë parash, dhe i tha atij se, nëse ai nuk mund t'ia kthente këto para brenda një periudhe kohore, dëshmitari do t'i jepte atij një ngastër toke në lagjen Jagllenica, Prizren. Toka nuk u bart asnjëherë në emrin e L. Mi.t. Këtë ngastër me sipërfaqe 13 ari, Sh.S e kishte blerë nga M. R për 120.000 DM. Dëshmitari i pagoi 90.000 euro Sh.it. Dy këste prej 30.000 eurosh iu paguan Sh.it dhe kësti i tretë prej 30.000 eurosh iu paguan drejtpërdrejt nënës së Sh.it. Më vonë dëshmitari i shiti A.B tokë në sipërfaqe 6 ari me çmimin 90.000 euro. Ata përgatitën një kontratë me shkrim dhe të pranishëm ishin S.J dhe O.B.

Ndërsa, në dëshminë e dhënë në Prokurori më 02 nëntor 2009, dëshmitari deklaroi se në vitet 2000-2001 ai bleu një ngastër në lagjen Jagllenica nga një pronar me emrin M.R. Ngastra në fjalë ishte 12 ari dhe ai e bleu për 100.000 DM. Dëshmitari e regjistroi ngastrën në emër të tij. Më vonë, në 2003-2004, ai i shiti babait të Sh.Mt, L. Mi., një pjesë të kësaj ngastre, domethënë, ½, në sipërfaqe 6 ari. Dëshmitari nuk e barti ngastrën në emrin e blerësit, përkatësisht L., pasi ata nuk kishin kontratë me shkrim. L. Mi. e pagoi të gjithë shumën e parave për ngastrën që bleu. Më vonë L. shkoi te dëshmitari dhe i kërkoi atij t'i blinte ngastrën që ai ia kishte blerë dëshmitarit, sepse ishte në nevojë për para. Përsëri dëshmitari e bleu ngastrën në fjalë në sipërfaqe 6 ari me çmimin e 90.000 eurove. Ai ia dha të hollat të birit të tij, Sh.it. Në vitin 2007 dëshmitari ia shiti ngastrën A.B nga Suhareka. Të pranishëm gjatë blerjes ishin S.J dhe O.B. Çmimi i kontraktuar ishte 90.000 euro.

Kur dëshmoi gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor më 14 shtator 2011, dëshmitari Sh.S dëshmoi se, menjëherë pas luftës, ai bleu tokë në sipërfaqe 12 ari në lagjen Jagllenica, nga një pronar me emrin M.R. Ai nuk ishte i sigurt nëse pagoi 145.000 apo 155.000 DM. Në atë kohë Sha.i i detyrohej L.it 90.000 euro dhe me anë të një marrëveshjeje verbale ai i shiti L. Mi.t tokë në sipërfaqe 6 ari. Toka nuk u bart në emër të L. Mi.t. Më pas dëshmitari ra përsëri dakord gojarisht me L.in që dëshmitari t'ia kthente 90.000 eurot L.it. Sha.i i ktheu paratë kur ia shiti tokën A.B.

Siç e sheh Gjykata, dëshmitë e dëshmitarit Sh.S përmbajnë shumë papajtueshmëri dhe kundërthënie dhe, për rrjedhojë, ato nuk janë të besueshme në shumë pika. Vetëm dy fakte u mbështetën nga provat objektive se në vitin 2007 Sha.i i shiti A.B ngastrën në sipërfaqe 6 ari dhe në atë moment toka formalisht ishte e regjistruar nën emrin e Sha.it.

Dëshmitari S.J

Dëshmitari S.J u dëgjua në gjykatë më 16 janar 2014. Dëshmitari deklaroi se së bashku me O.B ai kishte qenë i pranishëm kur A.B bleu nga Sh.S tokën në Jagllenicë në sipërfaqe 6 ari, në vlerën 90.000 euro. Shuma e parë prej 30.000 eurosh u pagua në Suharekë në ditën kur u ble toka; dëshmitari nuk ka qenë i pranishëm kur janë dhënë 30.000 eurot e tjera. Dhe shuma e fundit prej 30.000 eurosh u dha në restorantin Kabashi. Atë ditë ata hëngrën darkë dhe u paguan paratë.

Dëshmia e këtij dëshmitari, S.J, ishte koherente dhe përputhej me deklaratat e tij të mëparshme të dhëna më 03 nëntor 2009 dhe 14 shtator 2011.

Dëshmitarja V.M.

Më 22 janar 2014, gjykata thirri dëshmitaren V.M., e cila deklaroi se e njeh Sh.Sn, ai është nga i njëjti fshat. Burri i saj, L. Mi., bleu nga Sh.S ngastrën e tokës në Jagllenicë për 100.000 euro. I pyetur nga kryetarja e trupit gjykues se më 2 nëntor 2009 përpara prokurorit dëshmitarja kishte deklaruar se ishin DM, dëshmitarja tha: Nuk jam në gjendje ta di tani. Në të vërtetë Sha.i i kishte borxh 100.000 DM burrit të saj; meqenëse Sha.i nuk ishte në gjendje t'i paguante paratë, atëherë në emër të borxhit Sha.i i dha burrit të saj një ngastër në Jagllenicë. Ngastra mbeti në emrin e Sha.it pasi ata nuk hartuan kontratë me shkrim. Pesë-gjashtë vjet më parë ata ia shitën të njëjtën ngastër Sh.St. Ata morën 70.000 euro nga Sh.S dhe ajo mori edhe 17.500 euro të tjera drejtpërdrejt nga Sha.i, bashkë me Sh.in.

Më 2 nëntor 2009, dëshmitarja V.M. deklaroi se në vitin 2007 bashkëshorti i saj ishte sëmurrur dhe ai donte të shiste ngastrën dhe t'ia jepte djalit të saj Sh., meqë ai ishte tregtar dhe kishte disa para borxh. Ai e pyeti Sha.in nëse ai ishte i interesuar të blinte ngastrën, dhe Sha.i pranoi ta blinte sërish ngastrën në fjalë. Shuma e parave e rënë dakord ishte 90.000 euro, por Sh.S nuk i pagoi kurrë këto para, edhe pse ishte i detyruar t'i paguante këto para brenda 2 javëve, dhe më në fund Sha.i shkoi në shtëpinë e dëshmitares me Sh.in dhe ata i dhanë asaj 17.500 euro. Ata i thanë asaj se ata e shitën ngastrën, por nuk i treguan asaj se kujt ia shitën dhe kush e shiti.

Më 22 janar 2014, ajo deklaroi më tej se Sh.S i kishte dhënë djalit të saj Sh. 70.000 euro. Arsyja pse ata e shitën tokën ishte sepse ata kishin borxhe ndaj bankave.

Për mendimin e Gjykatës, dëshmitë e dëshmitares V.M. përmbajnë disa parregullsi, papajtueshmëri dhe mospërputhje. Siç e sheh Gjykata, dëshmia e dëshmitares V.M. nuk është e besueshme në disa pika.

Vetëm dy rrethana u mbështetën nga provat objektive se në vitin 2007 Sha.i i shiti A.B ngastrën në sipërfaqe 6 ari dhe se në atë moment toka formalisht ishte e regjistruar nën emrin e Sha.it (prova E9).

Dëshmia e Ar.B, e dhënë në prokurori më 21 tetor 2009

Gjykata u përpoq të thërrasë si dëshmitar Ar. B, por gjykata mori informacion nga posta se ai është jashtë shtetit. Gjatë gjykimit më 27 janar 2014, gjykata me marrëveshjen e të gjitha palëve e konsideroi si të lexuar dëshminë e Ar.B të dhënë në prokurori më 21 tetor 2009.

Kur dëshmoi në Prokurori më 21 tetor 2009, dëshmitari Ar.B deklaroi se Sh.M nuk i kishte marrë kurrë ndonjë borxh atij. Në pyetjen e Prokurorit nëse ai dinte apo kishte dijeni se Sh.M kishte marrë ndonjë borxh nga A.B, dëshmitari Ar.B deklaroi se ai nuk e di. Dëshmitari mohoi të kishte dijeni nëse A.B kishte blerë nga i dëmtuari Sh.M një ngastër në Prizren në lagjen Jagllenicë.

I pandehuri A.B

Ai dëshmoi gjatë seancës kryesore më 19 shkurt 2014 dhe konfirmoi deklaratën e tij të mëhershme të dhënë në prokurori më 20 tetor 2009 dhe në shqyrtimin e parë më 13 dhe 14 shtator 2011.

Më 19 shkurt 2014, i pandehuri A.B deklaroi se ai nuk i dha kurrë para Sh.Mt kundrejt kamatës; ai bleu ngastrën me sipërfaqe 602 metra katrore nga Sh.S, me çmimin kontraktues 90,000 euro. Shuma prej 90.000 eurosh u pagua në tre këste, që do të thotë tri herë nga 30.000 euro. Dëshmitarët S.J dhe O.B ishin të pranishëm që në fillim, kur ai bëri marrëveshjen me Sh.Sn deri në këstin e fundit që iu pagua Sha.it.

Gjendja faktike

Nuk ka dyshim se kjo ngastër toke e përmendur në aktakuzë është 600 m², ngastra numër 5215/4 në Komunën e Prizrenit, në afërsi të restorantit “Mena”. Ekziston një konfirmim i vlefshëm i kontratës nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Palët në kontratë janë A.B dhe Sh.S.

Bartja e pronës së paT.dshme (tokë bujqësore, tokë ndërtimore, pyje dhe tokë pyjore, ndërtesa, banesa, lokale afariste) gjatë periudhës në fjalë, 2007-2008, ishte e rregulluar me ligjet e mëposhtme: a/ Ligji për Bartjen e Pronës së Paluajtshme të Kosovës (botuar në gazetën Zyrtare të KSA të Kosovës, nr 45/81, 29/86, i ndryshuar më 31 dhjetor 1990); b/ Ligji për Gjykatat e Rregullta, me amendamente (Gazeta Zyrtare e KSAK, nr. 21/78, i ndryshuar 2/89); c/ Ligji për Bazën e Marrëdhënieve Pronësore (Gazeta Zyrtare e RFSJ-së, nr. 6/80, 36/90 (i zbatueshëm deri në vitin 2009); d/ Ligji për Kontrata dhe Dëmet (Gazeta Zyrtare e RFSJ-së, nr. 29/78, 39/85, 45/89, 57/89); e/ Ligji për Verifikimin e Nënshkrimeve, Dorëshkrimeve dhe Kopjeve (prej vitit 1971), f/ Ligji për themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme (Ligji nr. 2002/5, UNMIK/REG/2002/22, e ndryshuar me Ligjin nr. 2003/13 për Ndryshimet dhe Plotësimet, i shpallur me Rregulloren e UNMIK -ut 2003/27, hyrë në fuqi më 18 gusht 2003). Sipas nenit 455 të LMD-së, kontrata e shitblerjes së paT.dshmërisë duhet të jetë në formë të shkruar, në të kundërtën do të jetë e pavlefshme. Neni 33 i Ligjit mbi Bazën e Marrëdhënieve Pronësore parashikon që, në bazë të punës ligjore, e drejta pronësore mbi paT.dshmërinë fitohet me regjistrimin në “librat noterialë kadastralë” apo ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme që është paraparë me ligj.

Neni 26 (14) i Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta parashikon se gjykatat komunale janë kompetente për të vendosur lidhur me procedurën e trashëgimisë, procedurën e ekzekutimit, procedurën e regjistrimit të drejtave mbi paT.dshmërinë, në rastet e ndarjes fizike, rregullimit të çështjes së kufijve, verifikimit të transkripteve, dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve, si dhe në çështje të tjera jashtë-gjyqësore të cilat, me ligj, janë vendosur nën juridiksionin e gjykatës.

Për më tepër, në bazë të nenit 7.1 të Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit të Drejtave mbi PaT.dshmëritë (Ligji nr. 2002/5, UNMIK/REG/2002/22, i ndryshuar me Ligjin nr. 2003/13 për Ndryshimet dhe Plotësimet, i shpallur me Rregulloren 2003/27 të UNMIK-ut, në fuqi që nga data 18 gusht 2003), me t'u themeluar Regjistri, asnjë bartje e mëpasme e të drejtave mbi paT.dshmërinë nuk do të jetë e vlefshme pa i regjistruar në përputhje me këtë ligj.

I dëmtuari pretendoi se ai ishte pronari i tokës, por sipas dokumenteve ai nuk ishte. Prova E9 e lëshuar nga Autoriteti Publik i Kosovës nuk është penguar kurrë nga askush. Duke marrë parasysh formën e detyrueshme të marrëveshjes dhe miratimin e saj zyrtar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës më datë 11 dhjetor 2008, nuk ka asnjë mënyrë ligjore për ta shpallur marrëveshjen të pavlefshme. Aktvendimi (eksponati E9) përmban udhëzimin për mjetin ligjor. I dëmtuari duhej të kishte paraqitur ankesë, në qoftë se do të ishte i pakënaqur, por ai nuk e bëri këtë.

Provë tjetër mbështetëse është dëshmia e S.Jt, i cili dëshmoi se ngastra u shit nga Sh.S tek A.B. O.B dhe S.J ishin të dy të pranishëm në momentin kur u lidh kontrata dhe kur u pagua kësti i parë 30.000 euro. Sipas dëshmitarëve, çdo gjë ishte konsensuale dhe në marrëveshje të përbashkët.

Sh.M pretendoi ndryshe. Megjithatë versioni i tij ishte kundërthënës dhe nuk u mbështet nga asnjë provë, me përjashtim të deklaratës së tij.

Nuk ka prova për përfshirjen e A.B në një vepër penale, sipas nenit 267 paragrafi 2 të KPK-së, nuk ka asnjë gjurmë se ai ka vepruar si "anëtar i grupit"; i dëmtuari mohoi çdo përdorim të forcës ndaj tij nga A.B. Sh.M deklaroi se A.B nuk kishte bërë ndonjë kërcënim ndaj tij. (Procesverbali i datës 6 dhjetor 2013, faqe 8).

Nuk është provuar se i pandehuri përdori ndonjë kërcënim apo forcë në marrjen e parave të tij, siç u shpjegua më lart, dhe, për këtë arsye, neni 267 paragrafi 1 i KPK-së, nuk është i zbatueshëm.

Edhe pse i pandehuri, rrjedhimisht, mohon çdo borxh dhënë të dëmtuarit Sh.M dhe po të kemi parasysh se fakti i dhënies së borxhit nuk u provua përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, nga pikëpamja teorike A.B me shumë gjasa nuk do të kishte rënë dakord për dhënien e borxhit, po të kishte pasur njohuri në lidhje me gjendjen reale financiare të të dëmtuarit.

Sa i përket kualifikimit ligjor alternativ të veprës penale sipas nenit 270 të KPK-së, kontraktimi për përfitim joproportional nga pasuria, nuk është e mjaftueshme të provohet fakti se “një sasi dukshëm joproportionale e pasurisë” u negociua “në këmbim”, por qëllimi kriminal ka një element tjetër mendor, siç është kryerja e veprës penale duke përfituar nga rrethanat e vështira financiare të të dëmtuarit, rrethanat e vështira të banimit, vuajtja, papërvoja ose paaftësia për të bërë gjykime. Asnjë prej këtyre elementeve nuk u provua nga prokurori.

Duke marrë parasysh të gjitha argumentet e mësipërme dhe përmbajtjen e nenit 396 paragrafi 9 të KPPK-së, gjykata është e detyruar të vërë në dukje në arsyetim nenin 390 paragrafi 3 të KPPK-së si arsyeja e drejtpërdrejtë e pafajësisë. Nuk është provuar se i pandehuri A.B e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar.

Akuza III e Aktakuzës

Në dëshminë gjatë shqyrtimit gjyqësor më 6 dhjetor 2013, Sh.M deklaroi se ishte dimri i vitit 2007 kur ai mori para me fajde edhe nga N.K në shumën 50.000 euro, me kamatë mujore 11%, ose 5.500 euro në muaj. Sh.i nuk e njihte Ne.n, por Arb.B e prezantoi atë me N.Kn.

Prokurori: Çfarë i kërkuat Arb.it?

Sh.M: Arb.i donte të hapte një punëtori mekanike për automjete në lagjen Jagllenicë dhe unë kisha nevojë për para dhe Arb.B më tha, “unë do të marr disa para, sepse kam punë tek tregtari i automjeteve Reforma”. Unë nuk e di nëse ai ishte tregtar i makinave BMW në Prishtinë, dhe kisha nevojë për para, prandaj e pyeta, “A nje dikë të cilit mund t’i kërkojmë para?” Arb.i tha, “Kam një mik nga Suhareka.” Pastaj Arb.i kontaktoi me të dhe ne morëm 50.000 euro nga N.K.

Prokurori: Ku u takuat me N.Kn dhe kush ishte i pranishëm dhe a bëtë ndonjë marrëveshje me shkrim?

Sh.M: Nuk e di se ku e takoi Arb.i atë, por kur ne morëm paratë nga ai, shkuam në shtëpinë e tij në Suharekë, në shtëpinë e Ne.t.

Prokurori: Para se të shkonit në shtëpinë e tij, cili negocioi për kushtet e kësaj?

Sh.M: Arb.B.

Prokurori: A ishit ju i pranishëm?

Sh.M: Gjatë negociatave mes Arb.it dhe N.Kt, jo. Ne ishim bashkë vetëm në rastin kur ne morëm paratë.

Sh.i i pagoi Ne.t vetëm kamatën, domethënë 5.500 euro për 10 muaj. Më vonë Sh.i nuk kishte më para për t'i dhënë Ne.t, dhe Ne. shkoi në dyqanin e Sh.it rreth 10 deri në 12 herë dhe mori mallra në vlerë 12.000 apo 13.000 euro.

Prokurori: A ia dhatë këto atij me nismën tuaj ose me vullnet të lirë, apo ai i mori me forcë?

Sh.M: Ai nuk i mori me forcë, por as unë nuk ishte i kënaqur t'ia jepja. Nuk ishte as pëlqimi im.

Prokurori: A ju ka kërcënr N.K ndonjëherë, apo a ka përdorur ndonjëherë forcë?

Sh.M: Asnjë prej tyre nuk përdori forcë, vetëm fjalë kërcëse dhe fyese.

Kryetarja e trupit gjykues: Ju nuk iu përgjigjët pyetjes. Pyetja ishte nëse N.K ka përdorur ndonjë forcë.

Prokurori: A përdori fjalë kërcëse N.K?

Sh.M: Po.

Kryetarja e trupit gjykues: Çfarë ishin ato?

Sh.M: Unë jam fshatar, kjo gjë mes nesh nuk do të përfundojë mirë, nuk ka mjaft vend për ne të dy në Kosovë.

Prokurori: Kur ishte kjo?

Sh.M: Për sa kohë që unë vazhdova të paguaj kamatën, asgjë nuk ndodhi dhe unë isha njeriu më i mirë në botë. Por, kur unë nuk munda të paguaj më, isha më i keqi.

....

Prokurori: Në deklaratën tuaj dhënë Prokurorit, ju nuk përmendët fare se N.K ju kërcënoi. Pse thoni kështu sot? Po i referohem deklaratës së tij të datës 14 tetor 2009, faqe 5, paragrafi i fundit. Pra kjo pjesë e deklaratës së tij është rreth N.Kt, ku

ai përmend të gjitha këto fakte, se mori para prej tij dhe pagoi kamatën, por ai nuk përmend asnjë nga kërcënimet që përmendi sot.

Sh.M: Sepse kam një fletore ku kam shkruar çdo detaj dhe i kam shënr aty edhe kërcënimet dhe kjo është arsyeja pse po e deklaroj sot.

Prokurori: Pse e mbani mend atë sot? Pse nuk e mbajtët mend këtë në vitin 2009, që është 4 vjet më parë, dhe kujtesa juaj duhet të ketë qenë më e freskët në atë kohë?

Sh.M: Sepse lexova bllokun e shënimeve dhe i pashë të gjitha këto, përfshirë kërcënimet.

Prokurori: Cilin bllok shënimesh?

Sh.M: Bllokun e shënimeve të mia personale.

Prokurori: A nuk e kishit atë në atë kohë?

Sh.M: E kisha, por nuk e kisha lexuar.

Në dëshminë e dhënë para policisë në datën 08.04.2009, Sh.M deklaroi ndër të tjera se ishte Arb.B ai që e prezantoi atë me N.Kn. Nga 50.000 eurot që ai i huazoi N.Kt, Sh.i i huazoi Arb.Bt 17.000 euro, me qëllim që ky i fundit të hapte servisën e tij D. në L. Marrëveshja ishte se Arb.B. do t'ia kthente borxhin Sh.it brenda dy muajve. Por nuk ndodhi kështu. Arb.i ia ka kthyer tashmë paratë Sh.it me këste të vogla.

Më 14.10.2009, Sh.M deklaroi para prokurorit publik se ai mori para me fajde edhe nga N.K më datën 01.11.2007, në shumën 50.000 euro, me kamatë mujore 11%, ose 5.500 euro në muaj. Sh.i i pagoi Ne.t vetëm kamatën, që do të thotë 5.500 euro për 10 muaj, duke filluar nga 01.11.2007 deri në 01.09.2008. Ai ishte i detyruar të kthente gjithëgjënë brenda 6 muajve. Megjithatë Sh.i nuk qe në gjendje ta bënte këtë, prandaj Ne. shkoi në dyqanin e Sh.it rreth 10 herë dhe mori mallra, roba të tekstilit, në emër të kamatës, në shumën 13.500 euro.

Dëshmia e tij mbështetet pjesërisht nga dëshmia e Arb.Bt si dhe nga deklarata e N.Kt. Si dëshmitari Arb.B, ashtu dhe i pandehuri N.K dëshmuan se nuk kishte pasur kamatë, sepse ishte borxh me afat të shkurtër. Përveç deklaratës së Sh.Mt, Gjykata nuk ka prova mbështetëse lidhur me shumën e kamatës, nëse ka pasur ndonjë kamatë. Duke marrë

parasysh mospërputhjen e dëshmive të të dëmtuarit, Gjykatës nuk i lejohet t'i trajtojë ato si të mbështetshme dhe të besueshme.

Dëshmitari Arb.B

Dëshmitari Arb.B dëshmoi gjatë shqyrtimit gjyqësor më 16 janar 2014. Ai deklaroi se Sh.M e takoi atë dhe i kërkoi para. Ai i tha Arb.it se po kalonte krizë financiare dhe i kërkoi 50.000 euro hua, pa kamatë, për një periudhë kohore për 2 javë ose 1 muaj, pasi donte të sillte disa mallra nga Singapori. Meqë Sh.i po shkonte për të marrë kredi nga banka Raiffeisen në shumën 80.000 euro, Arb.B vendosi t'i gjente atij 50.000 euro nga shoku i tij N.K. Ne. ishte shok i mirë i Arb.it. Dëshmitari vendosi të jetë garantues, sepse ai e dinte me siguri se Sh.i do ta merrte kredinë që po përgatitej nga Banka Raiffeisen. Kështu, Ne. i dha 50.000 euro Sh.it vetëm për disa javë, deri në një muaj; kur Sh.i të kthente paratë, ai do t'i jepte atij si dhuratë edhe katër rrota dhe katër goma Mercedesi të klasit E, ngjyrë bronzi. Ne. i dha paratë për shkak të besimit që pati tek Arb.B. Kur Sh.i mori më pas kredinë nga Banka Raiffeisen, ai pagoi një borxh tjetër që kishte; ai nuk pagoi paratë që kishte huazuar nga Ne.. Ne.t iu tha se mallrat që vinin nga Singapori ishin mbajtur në kufirin me Serbinë, dy kamionë me tekstile, dhe Sh.i duhej të paguante taksat doganore për këta dy kamionë. Në momentin kur u kërkuan paratë, Sh.M i tregoi Ne.t dokumentet e një dyqani dhe një ngastre dhe premtoi se, nëse ai nuk i kthente paratë, atëherë ai do t'i jepte atij dyqanin ose ngastrën, cilëndo. Pra, kjo ishte një lloj prove që u ofrua nga Sh.M dhe Arb.i. Pastaj, kur Sh.M nuk ishte në gjendje t'i kthente paratë brenda një muaji, djali i Ne.t u martua, dasma u bë në shtëpi. Sh.i kishte një Boutique. Ai mori disa tessa nga dyqani, një tortë dhe shkoi tek Ne. për ta uruar. Në të njëjtën kohë, po përgatitej një kredi nga banka BPB në shumën 300.000 euro, dhe Sh.i arriti ta bindë Ne.n se paratë do të ktheheshin brenda një muaji deri në gjashtë javë.

Kur dëshmoi më 22 tetor 2010, dëshmitari deklaroi se pasi Sh.i i kërkoi atij 50.000 euro borxh, ai i tha Sh.it se shuma që ai kërkonte ishte shumë e madhe, është shumë e vështirë për ta gjetur, por meqë Ne. ishte shoku i tij i mirë, së pari ai bisedoi me të në telefon, ndërsa ditën tjetër dëshmitari shkoi në shtëpinë e tij në Suharekë. Arb.i ia shpjegoi situatën Ne.t; ai i tha atij se Sh.Mn e njihte mirë, është i pasur dhe ka nevojë për para për 2 javë deri në 1 muaj. Pas 2-3 ditësh, Arb.i mori Sh.in dhe shkoi në shtëpinë e Ne.t në Suharekë, ata folën me Ne.n dhe Arb.i garantoi se Sh.i do t'i kthejë paratë, sepse, sipas mendimit të tij, Sh.i ishte në situatë të tillë që ai mund ta kthente borxhin; Sh.i kishte në pronësi disa dyqane dhe ai mendonte se ne nuk do të kishim problem.

Dëshmia e këtij dëshmitari, Arb.B, mbështetet pjesërisht nga dëshmia e Sh.Mt si dhe nga deklarata e N.Kt. Përveç deklaratës së Sh.Mt, Gjykata nuk ka prova mbështetëse lidhur me shumën e kamatës, nëse ka pasur ndonjë kamatë.

I pandehuri N.K

Ai dëshmoi gjatë shqyrtimit gjyqësor më 19 shkurt 2014 dhe konfirmoi deklaratën e tij të mëhershme të dhënë në Prokurori më 21 tetor 2009 dhe në shqyrtimin e parë gjyqësor më 15 shtator 2011.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor N.K deklaroi se Arb.B dhe Sh.M shkuan tek ai dhe Arb.i e prezantoi Sh.in si tregtar, i cili kishte një problem në atë kohë, problem monetar, dhe i kërkoi atij t'i jepte Sh.it para për një periudhë të caktuar kohe. Ne. më tej deklaroi ai ishte tradhtuar nga shoku i tij. Ne. i dha Sh.it 50.000 euro për 2 muaj, pa asnjë kamatë. Për sa i përket mjeteve financiare që Sh.i i kërkoi Ne.t, Sh.i ofroi dokumentin e një dyqani, të personit të autorizuar, të ngastrës dhe të një banese. Ne. ia bëri këtë favor Sh.it duke besuar se personi në fjalë ishte vërtet tregtar i suksesshëm dhe se ai po i kërkonte paratë në fjalë për mallrat që ishin në doganë.

Më 15 shtator 2011, Ne. deklaroi se kishte nevojë për disa rroba. pasi kishte një dasmë së afërmi. Ai bëri marrëveshje me Sh.in që të merrte tesha nga dyqanet e Sh.it. Sh.i i vlerësoi rrobat në shumën 10,000-12,000 euro. Sh.i nuk ia ktheu borxhin N.Kt.

Deklarata e tij mbështetet pjesërisht nga dëshmitë e Arb.Bt dhe Sh.Mt. Si dëshmitari Arb.B, ashtu dhe i pandehuri N.K dëshmuar se nuk kishte pasur kamatë sepse borxhi ishte borxh me afat të shkurtër. Përveç deklaratës së Sh.Mt, Gjykata nuk ka prova mbështetëse lidhur me shumën e kamatës, nëse ka pasur ndonjë kamatë.

Gjendja faktike

N.K pranoi se ai i dha Sh.Mt një borxh afat-shkurtër prej 50.000 eurosh, por pa kamatë. Paratë nuk ishin paguar deri në fund të shqyrtimit gjyqësor. Dëshmitari Arb.B konfirmoi gjithashtu faktin se N.K i dha para të dëmtuarit. Sh.M pretendoi se ai kishte dy ngarkesa me tekstile në Serbi, që vinin nga Singapori. Ai i dha N.Kt këtë argument si qëllim për të kërkuar borxh. N.K fillimisht nuk ishte dakord, por më pas mori vendim pozitiv duke marrë parasysh faktin se Sh.M kishte shumë dyqane dhe prandaj dukej se ishte i aftë ta shlyente borxhin e tij. Si dëshmitari, ashtu dhe i pandehuri dëshmuar se nuk kishte

asnjë kamatë, sepse ai ishte borxh afat-shkurtër. Përveç deklaratës së Sh.Mt, ne nuk kemi asnjë provë mbështetëse për shumën e kamatës, nëse kishte.

Duke pasur parasysh papajtueshmëritë në dëshmitë e të dëmtuarit, gjykatës nuk i lejohet t'i trajtojë ato si të mbështetshme dhe të besueshme. Ekziston edhe një element tjetër i rëndësishëm faktik: se ky borxh nuk iu kthye asnjëherë N.Kt, i cili mori vetëm disa mallra nga dyqani i Sh.Mt si shlyerje e shumës, që nuk i kalonin 12.000 eurot. Asnjë shumë tjetër parash nuk u pagua. Ne duhet të kujtojmë gjithashtu se i dëmtuari e gënjeu N.Kn duke i thënë se paratë i nevojiteshin për të paguar mallrat që po vinin nga Singapori. Duke marrë parasysh qëndrimin e Sh.Mt të praNr prej tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, se ai i mori borxh paratë për të paguar kreditë dhe borxhet marra më parë, gjykata vjen në përfundimin se faji i N.Kt nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

Sa i përket nenit 270 të KPK-së, kontraktimin për përfitim joproporcional nga pasuria, nuk është e mjaftueshme të provohet fakti se u negociua “një sasi dukshëm joproporcionale e pasurisë” “në këmbim”. Që të përmbushet qëllimi kriminal nevojiten elemente të tjera mendore, të tilla si kryerja e veprës penale duke përfituar nga rrethanat e vështira financiare të të dëmtuarit, rrethanat e vështira të strehimit, vështirësitë, mungesa e përvojës ose paaftësia për të bërë gjykime. Asnjë prej këtyre elementeve nuk është provuar nga prokurori lidhur me N.Kn. Madje do të ishte e papërshtatshme të pretendohet se dikush që, nga njëra anë, e paraqet veten si biznesmen i suksesshëm dhe, nga ana tjetër, deklaron në gjykatë se merr kredi për të paguar kreditorë të tjerë, është pa përvojë ose i paaftë për të bërë gjykime. Lidhur me rrethanat e vështira financiare, N.K nuk kishte dijeni për ato rrethana. Edhe po të supozohet se u lidh kontratë e pafavorshme për të dëmtuarin, elementet e tjera të lartpërmendura të veprës penale nuk janë plotësuar. Gjykata duhet të arrijë në përfundimin se nuk është kryer asnjë vepër penale nga N.K, për shkak të mungesës së elementeve të përmendura më sipër të veprës penale të parashikuar nga neni 270 i KPK-së.

Duke marrë parasysh të gjitha argumentet e mësipërme dhe përmbajtjen e nenit 396 paragrafi 9 të KPPK-së, gjykata është e detyruar të vërë në dukje në arsyetim Nenin 390 paragrafi 1 të KPPK-së si arsye të drejtpërdrejtë të pafajësisë.

Në bazë të nenit 390 paragrafi 1 të KPPK-së, kjo gjykatë gjen se akti me të cilin akuzohet i pandehuri N.K nuk përbën vepër penale.

Prandaj vendoset si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjyqtarja Mariola Pasnik
Kryetare e trupit gjykues

Christine Sengl
Proces-mbajtëse

MJET LIGJOR: Në bazë të nenit 398(1) të KPPK-së, personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë ndaj këtij Aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita që u dorëzohet kopja e këtij Aktgjykimi.